



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

PËR
NDALIMIN E ABUZIMIT ME TREGUN

Miraturar me Vendim Bordi nr. 71, datë 28.04.2023

KREU 1
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i rregullores

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave dhe procedurave të nevojshme për ndalimin e abuzimit me tregun, që lidhet me tregtimin bazuar në informacion të privilegjuar, zbulimin e paligjshëm të informacionit të privilegjuar dhe manipulimin e tregut, me qëllim mbrojtjen e investitorit, sigurimin e integritetit të tregut dhe rritjen e besimit në treg.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo rregullore është hartuar në bazë dhe për zbatim të neneve 343 deri 357 të ligjit nr. 62, datë 14.05.2020 “Për tregjet e kapitalit”, të referuar në këtë rregullore si “Ligji”.

Neni 3

Fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore zbatohet për të gjitha veprimet e cilitdo personi juridik / apo individi, që përbëjnë abuzim tregu, të cilat përfshijnë, manipulim të çmimeve për të krijuar treg të rremë; tregtimin e bazuar në informacionin e privilegjuar dhe tregtimin me tituj të personave të organeve drejtuese.
2. Kjo rregullore zbatohet për veprimet dhe mosveprimet e çdo personi brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, kur ky person ushtron aktivitet në Republikën e Shqipërisë në lidhje me të gjitha instrumentet financiare të mëposhtme:
 - a. të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar ose për të cilat është paraqitur një kërkesë për t'u pranuar për tregtim në një treg të rregulluar;
 - b. të tregtuara në një platformë shumëpalëshe të tregtimit (PSHT), të pranuar për tregtim në një (PSHT) ose për të cilat është paraqitur një kërkesë për t'u pranuar për tregtim;
 - c. të tregtuara në një platformë të organizuar të tregtimit (POT);
 - ç. instrumentet financiare, që nuk parashikohen në shkronjat "a", "b" dhe "c", kur çmimi apo vlera e tyre varet ose ka efekt në çmimin apo vlerën e instrumentit financiar të parashikuar në këto pika, duke përfshirë, por pa u kufizuar, kontratat e shkëmbimit për rrezikun e kreditit (credit default swaps) dhe kontratat financiare për diferencat.
3. Kjo rregullore aplikohet edhe për:
 - a. kontratat e mallrave bazë, në rastet kur nuk janë produkte të shitjes me shumicë të energjisë, kur transaksioni, urdhri apo sjellja ndikon ose ka pasur për qëllim të ndikojë në çmimin apo vlerën e instrumentit financiar të përmendur në pikën 2 të këtij neni;
 - b. llojet e instrumenteve financiare, duke përfshirë kontratat derivative për transferimin e rrezikut të kreditit, kur transaksioni, urdhri, kuotimi apo sjellja ka ndikuar ose ka pasur për qëllim të ndikojë në çmimin apo vlerën e një kontrate të mallrave bazë, ku çmimi apo vlera e kësaj kontrate varet nga çmimi apo vlera e këtij lloji të instrumentit financiar;
 - c. sjelljen në lidhje me treguesit referencë (benchmarks).
4. Rregullorja aplikohet gjithashtu për çdo transaksion, urdhër apo sjellje për instrumentet financiare, ashtu si parashikohen në pikat 2 dhe 3 të këtij neni, pavarësisht nëse këto transaksione, urdhra apo sjellje ndodhin në një treg të rregulluar apo platformë/vend tregtimi.

Neni 4 Përkufizime

Termat e mëposhtëm në këtë rregullore kanë këto kuptime:

1. **“Shpërndarje”** është procesi, anë të të cilit përcaktohet numri i titujve që do të merren nga investitorët, të cilët i kanë nënshkruar paraprakisht këto tituj ose kanë aplikuar për t'i përfituar ato.
2. **“Njoftim i duhur publik”** është bërja publike të informacionit në një mënyrë që mundëson akses të shpejtë dhe vlerësim të plotë dhe në kohë të informacionit nga publiku.
3. **“Opsioni Greenshoe”** është një opsion i dhënë nga ofruesi i titujve/emetuesi në favor të shoqërisë komisionere ose bankave të përfshira në nënshkrimin e ofertës, opsion ky i cili nëse do të ushtrohet nga banka apo shoqëria komisionere, do tu lejojë atyre të blejnë deri në një shumë të caktuar titujsh, me çmimin e ofertës përgjatë një periudhe të caktuar kohe pas ofertës së titujve.
4. **“Stabilizim ndihmës”** është përdorimi i një mekanizmi të mbishpërndarjes së titujve ose ushtrimi i një opsioni “greenshoe” nga shoqëritë komisionere ose bankat, në kuadër të një shpërndarje të konsiderueshme titujsh, ekskluzivisht për lehtësimin e procesit të stabilizimit të çmimit.
5. **“Programi i riblerjes”** është blerja e titujve të vet nga një shoqëri.
6. **“Kontrata e shkëmbimit për rrezikun e kreditit”** (*Credit default swap*) është një kontratë derivative, në të cilën njëra palë i paguan një tarifë palës tjetër, në këmbim të një pagese ose përfitimi tjetër në rastin e një ngjarjeje krediti (Credit Event) që lidhet me një njësi ekonomike reference dhe të çdo mospërbushjeje tjetër, në lidhje me atë kontratë derivative, e cila ka një efekt të ngjashëm ekonomik;
7. **“Marrëveshja e shkëmbimit për mospërbushje të detyrimit të borxhit shtetëror”** është një kontratë shkëmbimi për rrezikun e kreditit ku do të kryhet një pagesë ose përfitim tjetër në rast të një ngjarjeje krediti (Credit Event) ose mospagese në lidhje me një emetues shtetëror, siç përkufizohet në nenin 3, pika 97 të Ligjit;
8. **“Aktivitetet e krijimit të tregut”** janë aktivitetet e një shoqërie komisionere, ose një banke që ofron shërbime investimi apo një entitet të licencuar në një vend të huaj, që kanë të bëjnë me:
 - a. vendosjen e kuotimit të njëkohshëm dhe të dyanshme fikse me madhësi të krahasueshme dhe me çmime konkurruese, duke siguruar likuiditet në mënyrë të rregullt dhe të vazhdueshëm në treg;
 - b. përmbushjen e urdhrave të iniciuar nga klientët ose përgjigjen ndaj kërkesave të klientëve për tregtim nga ana e shoqërisë komisionere ose bankës, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre profesionale;
 - c. mbrojtjen e pozicioneve që rrjedhin nga përmbushja e funksioneve sipas pikave (a) dhe (b).

9. **“Mekanizmi i mbishpërndarjes (Overallotment)”** është një klauzolë në marrëveshjen e nënshkrimit ose marrëveshjen e menaxhimit kryesor (*Lead Management*), e cila lejon pranimin e nënshkrimeve ose ofertave për të blerë një numër më të madh titujsh sesa ofruar fillimisht.
10. **“Vendi kryesor”** në lidhje me një aksion është vendi i tregtimit të atij aksioni me qarkullimin më të lartë.
11. **“Person që përmbush përgjegjësi menaxheriale/person i ngarkuar me detyra administrimi”** është personi pranë i cili është:
- a. anëtar i organit administrativ ose mbikëqyrës të emetuesit;
 - b. funksionar kryesor, që nuk është anëtar i organeve të përmendura në shkronjën “a” të kësaj pike, i cili ka akses të marrë informacion të privilegjuar lidhur drejtpërdrejtë apo tërthorazi me emetuesin dhe ka kompetencë për të marrë vendime administrimi, të cilat ndikojnë në zhvillimet e ardhshme dhe perspektivat e veprimtarisë tregtare të këtij emetuesi.
12. **“Person i lidhur”** me një person është:
- a. bashkëshorti/bashkëshortja ose bashkëjetuesi/bashkëjetuesja, sipas kuptimit të dhënë në Kodin e Familjes;
 - b. fëmija në kujdestari, sipas legjislacionit të zbatueshëm;
 - c. i afërmi, i cili banon në të njëjtën banesë prej të paktën një viti nga data e transaksionit në fjalë;
 - ç. personi juridik, i cili administrohet nga një person që administron personin në fjalë ose nga një person i lidhur me personin në fjalë sipas shkronjave “a”, “b” ose “c” të kësaj pike, apo kontrollohet drejtpërdrejtë ose tërthorazi nga ky person, apo është themeluar në përfitim të këtij personi ose interesat ekonomike të të cilit janë në thelb ekuivalente me ato të këtij personi.
13. **“Ditë tregtimi”** është çfarëdo dite, gjatë së cilës vendi i tregtimit në fjalë është i hapur për tregtim.
14. **“Qarkullimi”** i një aksioni është shuma e rezultateve të shumëzimit të numrit të njësive të atij aksioni, të shkëmbyer midis blerësve dhe shitësve në një periudhë të caktuar kohore, në përputhje me transaksionet që ndodhin në një vend tregtimi ose ndryshe, me çmimin për njësi për çdo transaksion të tillë.
15. **“Pjesëmarrës tregu që jep të dhëna”** do të thotë një person i cili bën pjesë në cilëndo nga kategoritë e përcaktuara në pikat (a) deri në (d) të nenit 12, pika 1 ose të nenit 11, pika 2 të kësaj rregulloreje dhe zbulon informacionin gjatë një komunikimi në treg.
16. **“Stabilizim”** në përputhje me nenin 3, pika 99 është blerja ose oferta për blerjen e instrumenteve financiare, ose instrumenteve ekuivalente të lidhura me to, që kryhet nga një bankë ose një shoqëri komisionere në kuadër të një oferte formale të këtyre instrumenteve financiare, me qëllimin e vetëm për të ruajtur çmimin e tregut të këtyre instrumenteve

financiare për një periudhë të paracaktuar, për shkak të presionit për shitje mbi këto instrumente financiare.

17. **“Tregtim algoritmik”** është përdorimi e programeve kompjuterike, të cilat ekzekutojnë urdhëra, ku algoritmi (programi kompjuterik) vendos paraprakisht karakteristikat e urdhërit me ndërhyrje minimale/ose pa ndërhyrje njerëzore. Përdorimi i algoritmeve në procesin e pas-tregtimit (post trade) nuk nënkupton tregtim algoritmik.
18. **“Teknikë tregtimi algoritmik me frekuencë të lartë”** është teknika e tregtimit algoritmik që karakterizohet nga :
 - a. Ofrimi i një infrastrukture, e cila synon të minimizojë vonesat në rrjet gjatë transferimit dhe ekzekutimit të urdhrave me shpeshtësi të lartë;
 - b. Mekanizma që mundësojnë/lehtësojnë vendosje të urdhrat përmes një algoritmi apo akses elektronik me shpejtësi të lartë;
 - c. Vendosje e paracaktuar e karakteristikave të urdhrit pa ndërhyrje njerëzore;
 - ç. Norma të larta ditore të mesazheve që lidhen me urdhra, kuotime apo anulimet.

Të gjitha përkufizimet e tjera në këtë rregullore, kanë të njëjtin kuptim si ato në ligj.

KREU II ABUZIMI ME TREGUN

PËRJASHTIMET

Seksioni 1 Kriteret e përgjithshme

Neni 5

Përrjashtimi për programet e riblerjes së aksioneve dhe stabilizimi

1. Ndalimet e përcaktuara në nenet 22 dhe 23 të kësaj Rregulloreje nuk zbatohen për tregtimin e aksioneve të veta në programet e riblerjes kur:
 - a. detajet e plota të programit janë bërë të njohura përpara fillimit të tregtimit;
 - b. tregtimet i raportohen Autoritetit si pjesë e programit të riblerjes në përputhje me pikën (3) të këtij neni dhe më pas bëhen publike;
 - c. respektohen kufijtë e duhur në lidhje me çmimin dhe vëllimin;
 - ç. kryhen në përputhje me objektivat e përmendura në pikën (2) dhe kushtet e përcaktuara në këtë nen.
2. Për të përfituar nga përjashtimi i parashikuar në pikën (1) të këtij neni, programi i riblerjes duhet të ketë për qëllim të vetëm:

- a. zvogëlimin e kapitalit të një emetuesi;
 - b. përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga instrumentet financiare të borxhit, të cilat janë të këmbyeshme me/në instrumente kapitali;
 - c. përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga programet e opsioneve për aksionet ose shpërndarje të tjera të aksioneve për punonjësit ose për anëtarët e organeve administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse të emetuesit ose të një shoqërie të lidhur me të.
3. Për të përfituar nga përjashtimi i parashikuar në pikën (1) të këtij neni, emetuesi i raporton Autoritetit informacionet e mëposhtme:
- a. të dhëna në lidhje me të gjitha urdhrat dhe të gjitha transaksionet në instrumentet financiare që ata kanë kryer në pesë vitet e fundit, qoftë për llogari të tyre apo për llogari të një klienti.
 - b. në rastin e transaksioneve që kryhen në emër të klientëve siç përmendet në shkronjën (a) të kësaj pike, të dhënat duhet të përmbajnë të gjitha informacionet dhe detajet e identitetit të klientit.
 - c. në rastin e një operatori të një vendi tregtimi, të dhënat në lidhje me të gjitha urdhrat në instrumente financiare që reklamohen nëpërmjet sistemeve të tyre për pesë vitet e fundit. Këto të dhëna duhet të përmbajnë karakteristikat e urdhrat.
 - ç. detajet e llojeve dhe numrave të instrumenteve financiare të blera ose të shitura, sasia, datat dhe koha e ekzekutimit, çmimet e transaksionit, një përcaktim për të identifikuar klientët, në emër të të cilëve shoqëria komisionere ka ekzekutuar atë transaksion, një përcaktim për të identifikuar personat dhe algoritmet kompjuterike brenda shoqërisë komisionere përgjegjëse për vendimin e investimit dhe ekzekutimin e transaksionit, një përcaktim për të identifikuar heqjen e zbatueshme sipas të cilës është realizuar tregtimi, mjetet për identifikimin e shoqërive komisionere në fjalë dhe një përcaktim për të identifikuar një shitje të shkurtër në lidhje me çdo aksion dhe borxh shtetëror.
 - d. për transaksionet e parashikuara në shkronjën (e) të kësaj pike, që nuk kryhen në një vend tregtimi, një përcaktim që identifikon llojet e transaksioneve.
 - e. për derivativët e mallit, një tregues nëse transaksioni i kryer minimizon rrezikun në një mënyrë objektivist të matshme.
4. Ndalimet në nenet 22 dhe 23 të kësaj Rregulloreje nuk gjejnë zbatim në rastin e stabilizimit të titujve, kur:
- a. stabilizimi kryhet për një periudhë të kufizuar;
 - b. informacioni përkatës për stabilizimin bëhet i ditur dhe i njoftohet Autoritetit në përputhje me pikën (5) të këtij neni;
 - c. respektohen kufijtë e duhur në lidhje me çmimin.

5. Detajet e të gjitha transaksioneve të stabilizimit i njoftohen Autoritetit nga emetuesit apo entitetet që ndërmarrin stabilizimin, jo më vonë se fundi i sesionit të shtatë ditor të tregtimit pas datës së ekzekutimit të këtyre transaksioneve.

Seksioni 2 Programet e riblerjes

Neni 6 Detyrimi për njoftim dhe raportim

1. Për të përfituar nga përjashtimi i përcaktuar në nenin 5, pika (1) të kësaj Rregulloreje, përpara fillimit të tregtimit në një program riblerjeje, emetuesi duhet të sigurojë bërjen publike të informacioneve të mëposhtme:
 - a. qëllimin e programit siç parashikohet në nenin 5, pika (2) të kësaj Rregulloreje;
 - b. shumën maksimale monetare të caktuar për programin;
 - c. numrin maksimal të aksioneve që duhen blerë;
 - ç. periudhën, për të cilën është dhënë autorizimi për programin (kohëzgjatja e programit).
2. Emetuesi duhet të ketë mekanizma që e lejojnë të përmbushë detyrimet e raportimit ndaj Autoritetit dhe të regjistrojë çdo transaksion në lidhje me një program riblerjeje, duke përfshirë informacionin e specifikuar në nenin 5, pika (3) të kësaj Rregulloreje. Emetuesi duhet t'i raportojë Autoritetit çdo vend tregtimi në të cilin aksionet janë pranuar për tregtim ose po tregtohen, jo më vonë se deri në fund të sesionit të shtatë ditor të tregtimit pas datës së ekzekutimit të transaksionit, të gjitha transaksionet që kanë të bëjnë me programin e riblerjes, në formë të detajuar dhe në formë të përmbledhur. Formulari i përmbledhur duhet të tregojë vëllimin e agreguar dhe çmimin mesatar të ponderuar ditor dhe për vende tregtimi.
3. Emetuesi duhet të bëjë publik informacionin mbi transaksionin që lidhet me programin e riblerjes, të parashikuar në pikën (2) të këtij neni jo më vonë se deri në fund të sesionit të shtatë ditor të tregtimit pas datës së ekzekutimit të një transaksioni të tillë. Këto transaksione duhet të publikohen nga emetuesi edhe në faqen e tij të internetit. Informacioni i disponueshëm për publikun duhet të ruhet për të paktën një periudhë 5-vjeçare nga data e njoftimit publik.

Neni 7 Kushtet për tregtim

1. Për të përfituar nga përjashtimi i parashikuar në nenin 5, pika (1) të kësaj Rregulloreje, transaksionet në lidhje me programet e riblerjes duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:
 - a. aksionet duhet të blihen nga emetuesi në një vend tregtimi ku aksionet janë pranuar për tregtim ose po tregtohen;

- b. për aksionet që tregtohen vazhdimisht në një vend tregtimi, urdhrat nuk duhet të vendosen gjatë një faze ankandi dhe urdhrat e vendosura përpara fillimit të fazës së ankandit nuk duhet të modifikohen gjatë asaj faze;
 - c. për aksionet që tregtohen vetëm në një vend tregtimi nëpërmjet ankandeve, urdhrat do të jepen dhe modifikohen nga emetuesi gjatë ankandit me kusht që pjesëmarrësit e tjerë të tregut të kenë kohë të mjaftueshme për të reaguar ndaj tyre.
2. Për të përfituar nga përjashtimi i parashikuar në nenin 5, pika (1) të kësaj Rregulloreje, kur kryejnë transaksione në kuadër të një programi riblerjeje, emetuesit nuk do të blejnë aksione me një çmim më të lartë sesa çmimi më i lartë ndërmjet tregtimit të fundit të pavarur dhe ofertës aktuale më të lartë për blerje të pavarur, në vendin e tregtimit ku kryhet blerja, duke përfshirë edhe aksionet që tregtohen në vende të ndryshme tregtimi.
 3. Emetuesit kur kryejnë transaksione në kuadër të një programi riblerjeje, nuk duhet të blejnë në asnjë ditë tregtimi më shumë se 25% të vëllimit mesatar ditor të aksioneve në vendin e tregtimit në të cilin kryhet blerja.

Për qëllim të kësaj dispozite, vëllimi mesatar ditor bazohet në vëllimin mesatar ditor që tregtohet gjatë njërës prej periudhave të mëposhtme:

- a. në muajin që i paraprin muajit të njoftimit sipas nenit 6, pika (1) të kësaj Rregulloreje, një vëllim i tillë fiks duhet të parashikohet në programin e riblerjes dhe të aplikohet gjatë kohëzgjatjes së atij programi;
- b. 20 ditët e tregtimit para datës së blerjes, kur programi nuk i referohet atij vëllimi.

Neni 8

Kufizimet në tregtim

1. Për të përfituar nga përjashtimi i parashikuar në nenin 5, pika (1) të kësaj Rregulloreje, emetuesi nuk duhet të angazhohet, gjatë kohëzgjatjes së programit të riblerjes, në aktivitetet e mëposhtme:
 - a. shitje të aksioneve të veta;
 - b. tregtim gjatë periudhës së mbyllur të parashikuar në nenin 27, pika (11) të kësaj Rregulloreje;
 - c. tregtim në rast se emetuesi ka vendosur të vonojë njoftimin publik të informacionit të privilegjuar në përputhje me nenin 25, pika (3) ose (4) të kësaj Rregulloreje.
2. Pika (1) e këtij neni nuk zbatohet kur programi i riblerjes drejtohet nga një shoqëri komisionere ose një bankë që kryen shërbime investimi, e cila merr vendimet e veta për tregtim në lidhje me kohën e blerjes së aksioneve të emetuesit, në mënyrë të pavarur nga emetuesi.

3. Pika 1, shkronja (a) e këtij neni nuk zbatohet nëse emetuesi është një shoqëri komisionere ose bankë dhe ka krijuar, zbatuar dhe mbajtur rregulla dhe procedura të brendshme të përshtatshme dhe efikase, që i nënshtrohen mbikëqyrjes së Autoritetit, për të parandaluar përhapjen e paligjshme të informacionit të privilegjuar nga personat që kanë akses në informacionin e privilegjuar në lidhje me emetuesin drejtpërdrejt ose tërthorazi tek personat përgjegjës për çdo vendim në lidhje me tregtimin e aksioneve të veta, kur tregtojnë aksionet e veta në bazë të një vendimi të tillë.
4. Pika 1, shkronjat (b) dhe (c) të këtij neni nuk zbatohen nëse emetuesi është një shoqëri komisionere ose bankë dhe ka krijuar, zbatuar dhe mbajtur rregulla dhe procedura të brendshme të përshtatshme dhe efikase, subjekt i mbikëqyrjes nga Autoriteti, për të parandaluar përhapjen e paligjshme të informacionit të privilegjuar, nga personat që kanë akses në informacionin e privilegjuar që lidhet me emetuesin drejtpërdrejt ose tërthorazi, duke përfshirë vendimet e blerjes në kuadër të programit të riblerjes, personat përgjegjës për çdo vendim që lidhet me tregtimin e aksioneve të veta në emër të klientit, kur ata tregtojnë aksionet e veta në emër të këtyre klientëve.

Seksioni 3 Masat e stabilizimit

Neni 9 Kushtet në lidhje me periudhën e stabilizimit

1. Në lidhje me aksionet dhe titujt e tjerë të barasvlershme me aksionet, periudha e kufizuar e parashikuar në nenin 5, pika 4, shkronja (a) të kësaj Rregulloreje (më tej “periudha e stabilizimit”) duhet që:
 - a. në rastin e një shpërndarjeje të konsiderueshme në formën e një oferte fillestare të shpallur publikisht, të fillojë në datën e fillimit të tregtimit të titujve në vendin e tregtimit në fjalë dhe të përfundojë jo më vonë se 30 ditë kalendarike pas kësaj;
 - b. në rastin e një shpërndarjeje të konsiderueshme në formën e një oferte dytësore, të fillojë në datën e njoftimit publik të çmimit përfundimtar të titujve dhe të përfundojë jo më vonë se 30 ditë kalendarike pas datës së alokimit.
2. Për qëllim të pikës 1, shkronja (a) të këtij neni, kur bëhet oferta fillestare e shpallur publikisht që lejon tregtimin përpara fillimit të tregtimit në një vend tregtimi, periudha e stabilizimit duhet të fillojë në datën e njoftimit të përshtatshëm publik të çmimit përfundimtar të titujve dhe të zgjasë jo më shumë se 30 ditë kalendarike pas këtij afati. Një tregtim i tillë do të kryhet në përputhje me rregullat e zbatueshme të vendit të tregtimit në të cilin titujt do të pranohen për tregtim, duke përfshirë çdo rregull në lidhje me njoftimin publik dhe raportimin e tregtimit.
3. Në lidhje me obligacionet dhe format e tjera të borxhit të titullzuar, duke përfshirë borxhin e titullzuar të konvertueshëm ose të këmbyeshëm në aksione ose në tituj të tjerë të barasvlershme me aksionet, periudha e stabilizimit do të fillojë në datën e njoftimit të caktuar publik të kushteve të ofertës së titujve dhe do të mbarojë jo më vonë se 30 ditë kalendarike

pas datës, në të cilën emetuesi i instrumenteve ka marrë të ardhurat nga emetimi, ose jo më vonë se 60 ditë kalendarike pas datës së shpërndarjes së titujve, cilado qoftë më e hershme.

Neni 10

Detyrimet për njoftim dhe raportim

1. Para fillimit të ofertës fillestare ose dytësore të titujve, personi i caktuar në përputhje me pikën 5 të këtij neni, duhet të sigurojë njoftimin e duhur publik të informacionit në vijim:
 - a. faktin që stabilizimi mund të mos ndodhë domosdoshmërisht dhe se ai mund të ndalojë në çdo kohë;
 - b. faktin që transaksionet e stabilizimit synojnë të mbështesin çmimin e tregut të titujve gjatë periudhës së stabilizimit;
 - c. fillimin dhe mbarimin e periudhës së stabilizimit, gjatë së cilës mund të kryhet stabilizimi;
 - ç. identitetin e njësisë ekonomike që ndërmerr stabilizimin, përveç rasteve kur nuk dihet në momentin e njoftimit, rast në të cilin do t'i nënshtrohet njoftimit të përshtatshëm publik përpara se të fillojë stabilizimi;
 - d. ekzistencën e çdo faciliteti/mekanizmi “greenshoe” ose opsioni “greenshoe” dhe numrin maksimal të titujve që mbulohen nga ajo lehtësi ose ai opsion, periudha gjatë së cilës mund të ushtrohet opsioni greenshoe dhe çdo kusht për përdorimin e facilitetit “greenshoe” ose ushtrimin e opsionit “greenshoe”;
 - e. vendin ku mund të ndërmerret stabilizimi, duke përfshirë, sipas rastit, emrin e vendit të tregtimit.
2. Gjatë periudhës së stabilizimit, personat e caktuar sipas pikës 5 të këtij neni duhet të sigurojnë njoftimin publik të detajeve të të gjitha transaksioneve stabilizuese, jo më vonë se fundi i sesionit të shtatë ditor të tregut pas datës së ekzekutimit të transaksioneve të tilla.
3. Brenda një jave nga përfundimi i periudhës së stabilizimit, personi i caktuar në përputhje me pikën 5 të këtij neni duhet të sigurojë njoftimin publik të informacioneve në vijim:
 - a. nëse stabilizimi është ndërmarrë apo jo;
 - b. datën në të cilën ka filluar stabilizimi;
 - c. datën në të cilën ka ndodhur për herë të fundit stabilizimi;
 - ç. diapazonin e çmimeve brenda të cilit është kryer stabilizimi, për secilën nga datat gjatë të cilave janë kryer transaksionet e stabilizimit;
 - d. vendet e tregtimit në të cilat janë kryer transaksionet e stabilizimit, aty ku është e zbatueshme.

4. Për qëllimin e respektimit të kriterit të njoftimit të përcaktuar në nenin 5, pika 5 të kësaj Rregulloreje, subjektet që ndërmarrin stabilizimin, pavarësisht nëse veprojnë ose jo në emër të emetuesit, do të regjistrojnë çdo urdhër ose transaksion stabilizimi në tituj dhe instrumentet shoqëruese. Subjektet që ndërmarrin stabilizimin, pavarësisht nëse veprojnë ose jo në emër të emetuesit, duhet t'i njoftojnë Autoritetit të gjitha transaksionet e stabilizimit në tituj dhe instrumentet shoqëruese.
5. Emetuesi dhe çdo subjekt që ndërmerr stabilizimin, si dhe personat që veprojnë në emër të tyre, duhet të caktojë një prej tyre që të veprojë si pikë qendrore përgjegjëse:
 - a. për kriteret e njoftimit publik të parashikuara në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni;
 - b. për trajtimin e çdo kërkesë nga Autoriteti, parashikuar në pikën 4 të këtij neni.

Neni 11 **Kushtet e çmimeve**

1. Në rastin e ofertës së aksioneve ose titujve ekuivalentë me aksionet, stabilizimi i titujve nuk do të kryhet në asnjë rrethanë mbi çmimin me të cilin është bërë oferta.
2. Në rastin e një oferte të borxhit të titulluar të konvertueshëm ose të këmbyeshëm në aksione ose në tituj të tjerë ekuivalente me aksione, stabilizimi i këtyre instrumenteve të borxhit nuk do të kryhet në asnjë rrethanë mbi çmimin e tregut të këtyre instrumenteve në kohën e njoftimit publik të kushteve përfundimtare të ofertës së re.

Neni 12 **Kushtet për stabilizim ndihmës**

Stabilizimi ndihmës duhet të ndërmerret në përputhje me nenet 10 dhe 11 të kësaj Rregulloreje dhe në përputhje me kushtet e mëposhtme:

- a. titujt duhet të mbishpërndahen vetëm gjatë periudhës së nënshkrimit dhe me çmimin me të cilin është bërë oferta;
- b. pozicioni që rezulton nga ushtrimi i një faciliteti “greenshoe” nga një shoqëri komisionere ose bankë, e cila nuk mbulohet nga opsioni “greenshoe” nuk duhet të kalojë 5% të ofertës fillestare;
- c. opsioni “greenshoe” duhet të ushtrohet nga përfituesit e një opsioni të tillë vetëm kur titujt janë mbishpërndarë;
- ç. opsioni “greenshoe” nuk duhet të jetë më shumë se 15% e ofertës fillestare;
- d. periudha gjatë së cilës mund të ushtrohet opsioni “greenshoe” do të jetë e njëjtë me periudhën e stabilizimit në përputhje me nenin 9 të kësaj Rregulloreje;

- e. ushtrimi i opsionit “greenshoe” duhet t’i njoftohet publikut menjëherë, së bashku me të gjitha detajet e duhura, duke përfshirë në veçanti datën e ushtrimit të opsionit dhe numrin dhe natyrën e titujve të përfshira.

Seksioni 4 **Përfshirjet e mëtejshme**

Neni 13 **Përfshirje për aktivitetet monetare dhe të menaxhimit të borxhit publik si dhe për aktivitetet e politikave klimaterike**

Kjo rregullore nuk zbatohet për transaksionet, urdhrat ose sjelljet, që ndërmerren me qëllim ndjekjen e politikës monetare, të kursit të këmbimit ose të administrimit të borxhit publik nga Republika e Shqipërisë dhe ministritë, institucionet e vendit ose subjekte për qëllime të veçanta (SPV), ose nga një person që vepron në emër të tyre.

KREU III **DETYRIMET PËR NJOFTIM**

Neni 14 **Njoftimi dhe lista e instrumenteve financiare**

1. Operatorët e tregut të tregjeve të rregulluara dhe shoqëritë komisionere dhe operatorët e tregut që operojnë një PSHT ose një POT, duhet të njoftojnë pa vonesë Autoritetin për çdo instrument financiar për të cilin është bërë një kërkesë për pranim për tregtim në vendin e tyre të tregtimit, është pranuar për tregtim ose i cili tregtohet për herë të parë.

Ata gjithashtu duhet të njoftojnë Autoritetin kur një instrument financiar pushon së tregtuari ose së pranuari për tregtim, përveç rasteve kur data në të cilën instrumenti financiar pushon së tregtuari ose së pranuari për tregtim dihet dhe i është referuar në njoftimin e bërë në përputhje me nënparagrafin e parë.

Njoftimet e parashikuara në këtë pikë të dispozitës përfshijnë, sipas rastit, emrat dhe identifikuesit e instrumenteve financiare në fjalë, datën dhe orën e kërkesës për pranim në tregtim, pranimit për tregtim, si dhe datën dhe orën e tregtimit të parë.

Operatorët e tregut dhe shoqëritë komisionere i transmetojnë Autoritetit informacionet e përcaktuara në këtë dispozitë në lidhje me instrumentet financiare që kanë qenë objekt i kërkesës për pranim në tregtim.

2. Autoriteti publikon njoftimet e parashikuara në pikën 1 në faqen e tij të internetit, në formën e një liste, menjëherë pas marrjes. Autoriteti e përditëson atë listë menjëherë pas marrjes së çdo njoftimi të ri.
3. Lista duhet të përmbajë informacionet e mëposhtme:

- a. emrat dhe identifikuesit e instrumenteve financiare që janë objekt i një kërkesë për pranim në tregtim, pranimit në tregtim ose që tregtohen për herë të parë, në tregjet e rregulluara, PSHT dhe POT;
- b. datën dhe orën e kërkesave për pranim në tregtim, të pranimeve për tregtim ose të tregtimeve të para;
- c. detajet e vendeve të tregtimit në të cilat instrumentet financiare janë objekt i një kërkesë për pranim në tregtim, të pranuar në tregtim ose që tregtohen për herë të parë;
- ç. datën dhe orën në të cilën instrumentet financiare pushojnë së tregtuari ose nuk pranohen për tregtim.

KREU III

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME LIDHUR ME INFORMACIONIN E PRIVILEGJUAR DHE TREGTIMIN E BAZUAR NË INFORMACION TË PRIVILEGJUAR

Neni 15

Informacioni i privilegjuar

1. Në përputhje me nenin 350 të Ligjit dhe për qëllim të kësaj Rregulloreje, informacioni i privilegjuar përfshin llojet e mëposhtme të informacionit:
 - a. Informacion preciz, i cili nuk është bërë publik, që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi, me një ose më shumë emetues ose me një ose më shumë instrumente financiare dhe i cili, nëse do të ishte bërë publik, mund të kishte një efekt të rëndësishëm tek çmimet e këtyre instrumenteve financiare ose në çmimin e instrumenteve financiare derivative përkatëse;
 - b. në lidhje me derivativët e mallrave, informacionin preciz, i cili nuk është bërë publik, që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me një ose më shumë derivativë të tillë ose që lidhet drejtpërdrejt me kontratën e mallit përkatës dhe, i cili, nëse do të ishte bërë publik, mund të kishte një efekt të rëndësishëm në çmimet e këtyre derivativëve ose kontratave të mallrave përkatëse;
 - c. në lidhje me kuotat e lejuara të çlirimit të gazeve serrë ose produktet e ankandeve të bazuara në to, informacioni preciz, që nuk është bërë publik, që lidhet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, me një ose më shumë instrumente të tillë dhe që, nëse do të ishte bërë publik, mund të kishte një efekt të rëndësishëm në çmimet e këtyre instrumenteve ose në çmimet e instrumenteve financiare derivative përkatëse;
 - ç. për personat e ngarkuar me ekzekutimin e urdhrave në lidhje me instrumentet financiare, nënkupton gjithashtu informacionin preciz të përcjellë nga një klient dhe në lidhje me urdhrat në pritje të klientit në instrumentet financiare, që lidhet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, me një ose më shumë emetues ose me një ose më shumë instrumente financiare dhe, i cili, nëse do të ishte bërë publik, mund të kishte një efekt të rëndësishëm

në çmimet e këtyre instrumenteve financiare, çmimin e kontratave të mallrave të lidhura me to, ose në çmimin e instrumenteve financiare derivative përkatëse.

2. Në kuptim të pikës 1 të këtij neni, informacioni do të konsiderohet i natyrës precize nëse ai:
 - a. tregon një grup rrethanash që ekzistojnë, ose që mund të pritët në mënyrë të arsyeshme të krijohen, ose një ngjarje që ka ndodhur ose që në mënyrë të arsyeshme mund të pritët të ndodhë, kur është mjaft specifike për të bërë të mundur nxjerrjen e një konkluzioni si për efektin e mundshëm të atij grupi rrethanash ose ngjarjesh në çmimet e instrumenteve financiare ose të instrumentit financiar derivativ përkatës, të kontratave përkatëse të mallrave, ose të produkteve të nxjerra në ankand, bazuar në kuotat e lejuara për çlirimin e gazeve serrë;
 - b. Në lidhje me shkronjën (a), në rastin e një procesi të zgjatur që synon të sjellë ose që rezulton në rrethana të veçanta ose një ngjarje të caktuar, ato rrethana të ardhshme ose ajo ngjarje e ardhshme dhe gjithashtu hapat e ndërmjetëm të atij procesi që lidhen me sjelljen ose që rezultojnë në ato rrethana të ardhshme ose atë ngjarje të ardhshme, mund të konsiderohen si informacion preciz.
3. Hapi i ndërmjetëm në një proces të zgjatur do të konsiderohet si informacion i privilegjuar nëse, në vetvete, plotëson kriteret e informacionit të privilegjuar siç parashikohet në këtë nen.
4. Në kuptim të pikës 1, informacioni i cili, nëse do të ishte bërë publik, do të mund të kishte një efekt të rëndësishëm në çmimet e instrumenteve financiare, instrumenteve financiare derivative, kontratave të lidhura me mallrat ose produkteve të ankandëve, bazuar në kuotat e lejuara për çlirimin e gazeve serrë, nënkupton një informacion që një investitor i arsyeshëm mund ta përdorë si pjesë të bazës së vendimeve të tij për investime.

Në rastin e pjesëmarrësve në tregun e kuotave të lejuara për çlirimin e gazeve serrë me emetime agregate ose input termik të vlerësuar në ose nën pragun e përcaktuar në përputhje me nenin 25, pika 2 të kësaj Rregulloreje, informacioni për operacionet e tyre fizike do të konsiderohet se nuk ka një efekt domethënës në çmimin e kuotave të lejuara për çlirimin e gazeve serrë, të produkteve të ankandëve të bazuara në to, ose të instrumenteve financiare derivative.

5. Kur përcaktohet nëse informacioni konsiderohet si informacion i privilegjuar, duhet të merren në konsideratë këto fakte:
 - a. Kërkimet dhe vlerësimet e bazuara në të dhënat e disponueshme publikisht, nuk do të konsiderohen në vetvete si informacion i privilegjuar dhe fakti i thjeshtë që një transaksion është kryer në bazë të kërkimit ose vlerësimeve nuk duhet të konsiderohet, rrjedhimisht, si përdorim i informacionit të privilegjuar.
 - b. Në veçanti, kur publikimi ose shpërndarja e informacionit pritët në mënyrë rutinore nga tregu dhe kur ky publikim ose shpërndarje kontribuon në procesin e formimit të çmimit të instrumenteve financiare, ose informacioni ofron pikëpamje nga një komentues ose institucion i njohur tregu, i cili mund të njoftojë çmimet e instrumenteve financiare përkatëse, informacioni mund të përbëjë informacion të privilegjuar.

- c. Aktorët e tregut duhet të marrin në konsideratë shkallën në të cilën informacioni është jopublik dhe efektin e mundshëm në instrumentet financiare të tregtuara përpara publikimit ose shpërndarjes së tij, për të përcaktuar nëse ata do të tregtoheshin në bazë të informacionit të privilegjuar.

Neni 16

Tregtimi i bazuar në informacionin e privilegjuar

1. Në përputhje me nenin 351, pika 1 të Ligjit dhe për qëllimet e kësaj Rregulloreje, tregtimi i bazuar në informacion të privilegjuar lind edhe kur një person zotëron informacion të privilegjuar dhe e përdor atë informacion duke marrë ose likuiduar/shitur, për llogari të tij ose për llogari të një pale të tretë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, instrumentet financiare me të cilat lidhet ky informacion. Përdorimi i informacionit të privilegjuar duke anuluar ose ndryshuar një urdhër në lidhje me një instrument financiar me të cilin ka të bëjë informacioni kur porosia është bërë përpara se personi në fjalë të zotëronte informacionin e privilegjuar, do të konsiderohet gjithashtu tregtim i bazuar në informacion të privilegjuar.
2. Për qëllime të kësaj Rregulloreje, rekomandimi që një person tjetër të angazhohet në tregtimin e bazuar në informacion të privilegjuar ose nxitja e një personi tjetër që të përfshihet në tregtimin bazuar në informacion të privilegjuar, lind kur personi zotëron informacion të privilegjuar dhe:
 - a. rekomandon, bazuar në atë informacion, që një person tjetër të blejë ose të likuideojë/shesë instrumente financiare me të cilat lidhet ai informacion, ose e shtyn atë person të bëjë një blerje ose likuidim/shitje të tillë;
 - b. rekomandon, bazuar në atë informacion, që një person tjetër të anulojë ose të ndryshojë një urdhër në lidhje me një instrument financiar me të cilin ky informacion lidhet ose e shtyn atë person të bëjë një anullim ose ndryshim të tillë.
3. Përdorimi i rekomandimeve ose nxitjeve të parashikuara në pikën 2 të këtij neni, përbën tregtim me informacion të privilegjuar, kur personi që përdor rekomandimin ose nxitjen ka dijeni ose duhet të ketë dijeni, se ai bazohet në informacione të privilegjuar.
4. Ky nen zbatohet për çdo person që zotëron informacion të privilegjuar si rezultat i:
 - a. të qenit anëtar i organeve administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse të emetuesit, si pjesëtar tregu i kuotave të lejuara të çlirimit të gazeve serrë;
 - b. zotëron kapital tek emetuesi ose është pjesëtar tregu i kuotave të lejuara të çlirimit të gazeve serrë, ose ka të drejtë akses në informacion nëpërmjet ushtrimit të një punësimi, profesioni ose detyrash;
 - c. përfshirjes në aktivitete kriminale.

Kjo dispozitë zbatohet gjithashtu për çdo person që zotëron informacion të privilegjuar në rrethana të ndryshme nga ato të përmendura në pikën 1, kur ai person ka dijeni ose duhet të ketë dijeni, se ai është informacion i privilegjuar.

5. Kur kemi të bëjmë me një person juridik, ky nen zbatohet edhe për personat fizikë që marrin pjesë në vendimin për të kryer blerjen, shitjen/likuidimin, anulimin ose ndryshimin e një urdhri për llogari të personit juridik në fjalë.

Neni 17 **Sjellja legjitime**

1. Për qëllimet e neneve 16 dhe 22 të kësaj Rregulloreje, nuk do të konsiderohet abuzim tregu vetëm nisur nga fakti se një person juridik ka ose ka pasur në zotërim informacion të privilegjuar, që ai person e ka përdorur atë informacion dhe në këtë mënyrë është angazhuar në tregtimin e bazuar në informacion të privilegjuar, mbi bazën e një blerjeje ose shitje/likuidimi, kur ai person juridik:
 - a. ka krijuar, zbatuar dhe mbajtur rregulla dhe procedura të brendshme të përshtatshme dhe efikase që sigurojnë në mënyrë efikase se, as personi fizik që ka marrë vendimin në emër të tij për të blerë ose likuiduar/shitur instrumente financiare me të cilat lidhet informacioni, as një person tjetër fizik që mund të ketë pasur ndikim në atë vendim, ka pasur informacion të privilegjuar;
 - b. nuk ka inkurajuar, rekomanduar, nxitur ose ndikuar ndryshe personin fizik, i cili, në emër të personit juridik, ka blerë ose likuiduar/shitur instrumente financiare me të cilat lidhet informacioni.
2. Për qëllimet e neneve 16 dhe 22 të kësaj Rregulloreje, nuk do të konsiderohet abuzim tregu vetëm nisur nga fakti se një person zotëron informacion të privilegjuar, që ai person e ka përdorur atë informacion dhe, në këtë mënyrë është angazhuar në tregtimin e bazuar në informacion të privilegjuar në bazë të një blerjeje ose likuidimi/shitje, kur ai person:
 - a. për instrumentin financiar me të cilin lidhet ai informacion, është një krijues tregu ose një person i autorizuar për të vepruar si një kundërpalë dhe blerja ose likuidimi/shitja i instrumenteve financiare me të cilët lidhet ai informacion është bërë në mënyrë legjitime në rrjedhën normale të ushtrimit të funksionit të tij si krijues tregu, ose si kundërpalë për atë instrument financiar;
 - b. është i autorizuar të ekzekutojë urdhra në emër të palëve të treta, dhe blerja ose shitja/likuidimi i instrumenteve financiare me të cilat lidhet urdhri, është bërë për të zbatuar një urdhër të tillë në mënyrë legjitime në rrjedhën normale të ushtrimit të punësimit, profesionit, ose detyrave të atij personi.
3. Për qëllimet e neneve 16 dhe 22 të kësaj Rregulloreje, nuk do të konsiderohet abuzim tregu vetëm nisur nga fakti se një person zotëron informacion të privilegjuar, që ai person e ka përdorur atë informacion dhe, në këtë mënyrë është angazhuar në tregtimin e bazuar në informacion të privilegjuar në bazë të një blerjeje ose likuidimi/shitje, kur ai person kryen një transaksion për blerjen ose likuidimin/shitjen e instrumenteve financiare dhe ai transaksion kryhet në përmbushjen e një detyrimi që është bërë me mirëbesim dhe jo për të anashkaluar ndalimin e tregimit të bazuar në informacion të privilegjuar dhe:
 - a. ai detyrim rezulton nga një urdhër i vendosur ose një marrëveshje e lidhur përpara se personi në fjalë të zotëronte informacion të privilegjuar;

- b. ai transaksion është kryer për të përmbushur një detyrim ligjor ose rregullator që ka lindur përpara se personi në fjalë të zotëronte informacion të privilegjuar.
4. Për qëllimet e neneve 16 dhe 22 të kësaj Rregulloreje, nuk do të konsiderohet nga fakti se një person zotëron informacion të privilegjuar, që ai person e ka përdorur atë informacion dhe është angazhuar në këtë mënyrë në tregtimin bazuar në informacion të privilegjuar, kur personi e ka marrë atë informacion të privilegjuar gjatë marrjes në kontroll ose bashkimit me një kompani dhe e përdor atë informacion të privilegjuar vetëm për qëllimin e procedimit me atë bashkim ose blerje publike, me kusht që në pikën e miratimit të bashkimit ose pranimit të ofertës nga aksionerët e asaj shoqërie, çdo informacion i privilegjuar është bërë publik ose, për arsye të tjera, nuk përbën më informacion të privilegjuar.
 5. Për qëllimet e neneve 16 dhe 22 të kësaj Rregulloreje, fakti që një person përdor njohuritë e tij se ka vendosur të blejë ose të likuideojë/shesë instrumente financiare në blerjen ose likuidimin/shitjen e këtyre instrumenteve financiare, nuk përbën në vetvete përdorim të informacionit të privilegjuar.
 6. Pavarësisht nga parashikimet në pikat 1 deri në 5 të këtij neni, një shkelje e ndalimit të tregtimit të bazuar në informacion të privilegjuar, të përcaktuar në nenin 22 të kësaj Rregulloreje, ende mund të konsiderohet se ka ndodhur nëse Autoriteti vërteton se ka pasur një arsye të paligjshme për urdhrat për tregti, transaksione, ose sjelljet përkatëse.

Neni 18

Zbulimi i paligjshëm i informacionit të privilegjuar

1. Për qëllim të kësaj Rregulloreje, zbulimi i paligjshëm i informacionit të privilegjuar ndodh kur një person zotëron informacion të privilegjuar dhe ia njofton atë informacion kujtdo personi tjetër, përveç rasteve kur njoftimi bëhet në kuadër të ushtrimit normal të një veprimtarie, profesioni apo detyre.

Parashikimi i mësipërm zbatohet për çdo person fizik ose juridik në situatat ose rrethanat e parashikuara në nenin 16, pika 4 të kësaj Rregulloreje.

2. Njoftimi i mëtejshëm i rekomandimeve ose nxitjeve të parashikuara në nenin 16, pika 2 të kësaj Rregulloreje, përbën njoftim të paligjshëm të informacionit të privilegjuar sipas këtij neni, kur personi që jep rekomandimin ose nxitjen, ka dijeni ose duhej të kishte dijeni se rekomandimi apo nxitja e dhënë bazohet në informacion të privilegjuar.
3. Informacionet e listuara në Shtojcën I të kësaj Rregulloreje japin shembuj të informacioneve të privilegjuar të mundshme.

Neni 19

Komunikimi në treg

1. Komunikimi në treg përfshin komunikimin e informacionit, përpara shpalljes së një transaksioni, me qëllim që të vlerësohet interesi i investitorëve të mundshëm në një transaksion të mundshëm dhe kushtet që lidhen me të, si madhësia ose çmimi i tij i mundshëm, për një ose më shumë investitorë të mundshëm nga:

- a. një emetues;
 - b. një ofrues dytësor i një instrumenti financiar, në sasi ose vlerë të tillë që transaksioni të jetë i ndryshëm nga tregtimi i zakonshëm dhe të përfshijë një metodë shitjeje të bazuar në vlerësimin paraprak të interesit të mundshëm nga investitorët e mundshëm;
 - c. një pjesëmarrës në treg për kuotat e lejuara për çlirimin e gazeve serrë;
 - ç. një palë e tretë që vepron në emër ose për llogari të një personi, të parashikuar në pikat (a), (b) ose (c).
2. Dhënia e informacionit të privilegjuar nga një person që synon të bëjë një ofertë për blerjen e titujve të një shoqërie ose një bashkimi me një shoqëri, palëve që kanë të drejtën e titujve, përbën gjithashtu një komunikim tregu, me kusht që:
- a. informacioni është i nevojshëm për t'u mundësuar palëve që kanë të drejtën e titujve që të krijojnë një opinion mbi gatishmërinë e tyre për të ofruar titujt e tyre;
 - b. vullneti i palëve që kanë të drejtën e titujve për të ofruar titujt kërkohet në mënyrë të arsyeshme për vendimin për të bërë ofertën e marrjes në dorëzim ose bashkimin.
3. Pjesëmarrësi në treg që jep informacione, përpara kryerjes së një komunikimi në treg, duhet të marrë në konsideratë në mënyrë specifike nëse analiza e tregut do të përfshijë dhënien e informacionit të privilegjuar. Pjesëmarrësi në treg që jep informacione duhet të bëjë një procesverbal me shkrim për konkluzionin e tij dhe arsyet për këtë. Ai do t'ia japë këto të dhëna me shkrim autoritetit kompetent sipas kërkesës. Ky detyrim do të zbatohet për çdo zbulim informacioni gjatë gjithë kohës së komunikimit në treg. Pjesëmarrësi në treg që jep informacione do të përditësojë të dhënat me shkrim të parashikuara në këtë pikë në përputhje me rrethanat.
4. Për qëllimet e nenit 18, pika 1 të kësaj Rregulloreje, zbulimi i informacionit të privilegjuar të bërë gjatë një komunikimi në treg, do të konsiderohet se është bërë në ushtrimin normal të punësimit/veprimtarisë/profesionit, ose detyrave të një personi, ku pjesëmarrësi në treg që jep informacione vepron në përputhje me pikat 3 dhe 5 të këtij neni.
5. Në kuptim të pikës 4 të këtij neni, pjesëmarrësi në treg që jep informacione, përpara se të bëjë zbulimin:
- a. do të marrë miratimin e personit që merr komunikim në treg për të marrë informacione të privileguara;
 - b. do të informojë personin që merr komunikim në treg, duke i thënë se ai e ka të ndaluar ta përdorë atë informacion, ose të përpiqet ta përdorë atë informacion, duke marrë ose likuiduar/shitur, për llogari të tij ose për llogari të një pale të tretë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, instrumentet financiare që lidhen me atë informacion;
 - c. do të informojë personin që merr komunikim në treg, duke i thënë se ai e ka të ndaluar ta përdorë atë informacion, ose të përpiqet ta përdorë atë informacion, duke anuluar ose ndryshuar një urdhër që tashmë është bërë në lidhje me një instrument financiar me të cilin lidhet informacioni;

- ç. do të informojë personin që merr komunikim në treg duke i shpjeguar se, duke rënë dakord për të marrë informacionin, ai është i detyruar ta mbajë informacionin konfidencial.

Pjesëmarrësi në treg që jep informacione duhet të përpilojë dhe të mbajë një regjistër të të gjitha informacioneve të dhëna personit që merr komunikim në treg, duke përfshirë informacionin e dhënë në përputhje me shkronjat (a) deri (ç) të parashikuara më sipër dhe identitetin e investitorëve të mundshëm, të cilëve u është dhënë informacion, duke përfshirë, por pa u kufizuar në personat juridikë dhe fizikë që veprojnë në emër të investitorit të mundshëm, si dhe datën dhe orën e çdo zbulimi. Pjesëmarrësi në treg që jep informacione duhet t'ia japë atë regjistër Autoritetit sipas kërkesës.

6. Kur informacioni që është bërë i ditur gjatë një komunikimi në treg nuk është më informacion i privilegjuar sipas vlerësimit të pjesëmarrësit në treg që jep informacione, pjesëmarrësi në treg që jep informacione duhet të informojë marrësin në përputhje me rrethanat, sa më shpejt të jetë e mundur.

Pjesëmarrësi në treg që jep informacione do të mbajë një regjistër të informacioneve të dhëna në përputhje me këtë paragraf dhe ia ofron Autoritetit sipas kërkesës.

7. Pavarësisht nga dispozitat e këtij neni, personi që merr komunikim tregu do ta vlerësojë vetë nëse zotëron informacion të privilegjuar, ose kur nuk zotëron më informacion të privilegjuar.
8. Pjesëmarrësi në treg që jep informacione duhet të mbajë të dhënat e përcaktuara në këtë dispozitë për një periudhë prej të paktën pesë vjetësh.

Neni 20

Manipulimi i tregut

1. Do të përbëjnë manipulim të tregut:
- a. hyrja në transaksione ose vendosja e një urdhri për tregtim apo çdo sjellje, të cilat japin ose ka gjasa të japin sinjale të rreme ose mashtruese/keqorientuese për ofertën, kërkesën ose çmimin e instrumenteve financiare, një kontrate të lidhur me mallrat ose një produkti të nxjerrë në ankand bazuar në kuotat e lejuara për çlirimin e gazeve serrë, të cilat sigurojnë mbajtjen nëpërmjet një personi ose disa personave, që veprojnë në bashkëpunim, e çmimit të një ose disa prej instrumenteve financiare në një nivel artificial, përveçse nëse personi, i cili ka kryer transaksionin ose ka dhënë urdhrin për tregtim, vërteton se arsyet e tij për ta bërë këtë veprim janë legjitime dhe se këto transaksione ose urdhra tregtimi përputhen me praktikën e pranuar të tregut siç përcaktohet në nenin 21 të kësaj Rregulloreje;
 - b. transaksionet ose urdhrat për tregtim të kryera nëpërmjet përdorimit të pajisjeve fiktive, ose çdo formë tjetër mashtrimi/keqorientimi;
 - c. shpërndarja e informacionit përmes mediave, përfshirë internetin, ose me çfarëdo mjeti tjetër, i cili jep apo mund të japë sinjale të rreme ose mashtruese/keqorientuese për instrumentet financiare, përfshirë shpërndarjen e thashethemeve dhe lajmeve të rreme ose keqinformuese, në rastin kur personi që ka kryer shpërndarjen ka pasur dijeni ose duhej të kishte pasur dijeni se informacioni ka qenë i rremë ose keqinformues. Në lidhje

me gazetaret, kur veprojnë me cilësinë e gazetarit, shpërndarja e informacionit do të vlerësohet duke mbajtur parasysh rregullat që rregullojnë profesionin e tyre, me përjashtim kur ata përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë një avantazh ose fitim nga shpërndarja e informacionit në fjalë;

- ç. transmetimi i informacionit të rremë ose keqorientues ose ofrimi i të dhënave të rreme ose keqinformuese në lidhje me treguesit referencë (Benchmark) ku personi që ka bërë transmetimin ose ka dhënë informacionin ka pasur dijeni ose duhet të kishte dijeni se ai ishte i rremë ose keqinformues, ose çdo sjellje tjetër që manipulon llogaritjen e treguesit referencë.
2. Në veçanti, do të konsiderohen manipulim tregu veprimtaritë dhe sjelljet e mëposhtme, që rrjedhin nga përkufizimi i manipulimit të tregut sipas parashikimit të mësipërm:
- a. veprimtaria e një personi ose disa personave, të cilët veprojnë në bashkëpunim për të siguruar një pozitë dominuese për ofertën ose kërkesën për një instrument financiar, kontratat e lidhura me mallrat ose produktet e nxjerra në ankand bazuar në kuotat e lejuara për çlirimin e serrë me pasojë mbajtjen të pandryshueshme, në mënyrë të drejtpërdrejt apo të tërthortë, të çmimeve të shitblerjes ose krijimin e kushteve të tjera të padrejta tregtimi;
 - b. shitblerja e instrumenteve financiare në hapje apo mbyllje të tregut, me pasojë keqinformimin e investitorëve, të cilët veprojnë bazuar në çmimet e shfaqura, përfshirë hapjen apo mbylljen e çmimeve;
 - c. përfitimi nga përdorimi i rastësishëm ose i rregullt i mediave tradicionale apo elektronike për shprehjen e një opinioni për një instrument financiar ose tërthorazi për emetuesin e tij, pasi është mbajtur ka hapur paraprakisht pozicione për këtë instrument financiar, duke përfituar më pas nga ndikimi i opinionit të shprehur për çmimin e këtij instrumenti, pa informuar njëkohësisht publikun në mënyrë të duhur e me efikasitet për konfliktin e interesit;
 - ç. dhënia e urdhrave në një vend tregtimi, duke përfshirë çdo anulim ose modifikim të tyre, me çdo mjet tregtimi të disponueshëm, duke përfshirë mjetet elektronike, të tilla si teknika algoritmike apo teknika të tregtimit me frekuencë të lartë, si dhe që ka një nga efektet e parashikuara në pikën 1, shkronja (a), ose pikën 1, shkronja (b) të këtij neni, nga:
 - i. ndërprerja ose vonesa e funksionimit të sistemit të tregtimit të vendit të tregtimit ose ekziston probabiliteti për ta bërë këtë;
 - ii. vështirësi për personat e tjerë i identifikimit të porosive të vërteta në sistemin e tregtimit të vendit të tregtimit ose ekziston probabiliteti për ta bërë këtë, duke përfshirë dhënien e urdhrave që rezultojnë në mbingarkimin ose destabilizimin e librit të urdhrave;
 - iii. krijimi ose probabiliteti për të krijuar një sinjal të rremë ose mashtrues/keqorientues në lidhje me ofertën, kërkesën ose çmimin e një instrumenti financiar, veçanërisht duke dhënë urdhra për të nisur ose përkeqësuar një trend;

- d. përfitimi i aksesit të rastësishëm ose të rregullt në median tradicionale ose elektronike, duke shprehur një opinion për një instrument financiar, kontratë të lidhur me mallrat, ose një produkt të nxjerrë në ankand bazuar në kuotat e lejuara për çlirimin e gazeve serrë (ose në mënyrë të tërthortë për emetuesin e tij), ndërkohë që ka marrë më parë pozicione në atë instrument financiar, kontratë të lidhur me mallra ose një produkt të nxjerrë në ankand, bazuar në kuotat e lejuara për çlirimin e gazeve serrë dhe duke përfituar më pas nga ndikimi i opinioneve të shprehura mbi çmimin e atij instrumenti, kontratën përkatëse të mallit, ose një produkt të nxjerrë në ankand bazuar në kuotat e lejuara për çlirimin e gazeve serrë, pa zbuluar në të njëjtën kohë atë konflikt interesi për publikun në mënyrë të duhur dhe efikase;
 - e. blerja ose shitja në tregun sekondar të kuotave të lejuara për çlirimin e gazeve serrë ose derivateve të lidhura me to përpara ankandit të mbajtur me efekt fiksimit e çmimit të pastër për produktet e ankandeve në një nivel jonormal ose artificial, ose të ofertuesve mashtrues/keqorientues që ofertojnë në ankande.
3. Në zbatim të pikës 1, shkronja (a) të këtij neni dhe pa cenuar format e sjelljes të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, treguesit e mëposhtëm jo shterues, të cilët nuk do të konsiderohen domosdoshmërisht në vetvete, se përbëjnë manipulim tregu, do të merren në konsideratë kur transaksionet ose urdhrat për tregtim të shqyrtohen nga pjesëmarrësit e tregut dhe Autoriteti:
- a. shkalla në të cilën urdhrat për të tregtuar të dhëna ose transaksionet e ndërmarra përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të vëllimit ditor të transaksioneve në instrumentin financiar përkatës, kontratën e lidhur me mallin ose produktin e nxjerrë në ankand bazuar në kuotat e lejuara për çlirimin e gazeve serrë, veçanërisht kur këto aktivitete çojnë në një ndryshim të rëndësishëm në çmimet e tyre;
 - b. shkalla në të cilën urdhrat për të tregtuar të dhëna ose transaksionet e ndërmarra nga persona me një pozicion të rëndësishëm blerjeje ose shitjeje në një instrument financiar, një kontratë e lidhur me mallra, ose një produkt që nxirret në ankand bazuar në kuotat e lejuara për çlirimin e gazeve serrë, çojnë në ndryshime të rëndësishme në çmim, të atij instrumenti financiar, kontratës përkatëse të mallrave, ose produktit të nxjerrë në ankand, bazuar në kuotat e lejuara për çlirimin e gazeve serrë;
 - c. nëse transaksionet e ndërmarra nuk çojnë në asnjë ndryshim në pronësinë përfituese të një instrumenti financiar, të një kontrate të lidhur me mallra, ose një produkt të nxjerrë në ankand bazuar në kuotat e lejuara për çlirimin e gazeve serrë;
 - ç. shkalla në të cilën urdhrat për tregtim, të dhënat ose transaksionet e ndërmarra ose urdhrat e anuluar, përfshijnë anulimet e pozicionit në një periudhë të shkurtër dhe përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të vëllimit ditor të transaksioneve në instrumentin financiar përkatës, një kontratë të lidhur me mallrat, ose një produkt të nxjerrë në ankand bazuar në kuotat e lejuara për çlirimin e gazeve serrë dhe mund të shoqërohet me ndryshime të rëndësishme në çmimin e një instrumenti financiar, një kontratë të lidhur me mallra, ose një produkt të nxjerrë në ankand bazuar në kuotat e lejuara të çlirimit të gazrave serrë;
 - d. shkalla në të cilën urdhrat për tregtim, të dhënat ose transaksionet e ndërmarra përqendrohen brenda një periudhe të shkurtër kohore në sesionin e tregtimit dhe çojnë në një ndryshim çmimi, i cili më pas anulohet;

- e. shkalla në të cilën urdhrat për tregtim ndryshojnë përfaqësimin e çmimeve të blerjes dhe shitjes më të mirë në një instrument financiar, një kontratë të lidhur me mallra, ose një produkt i nxjerrë në ankand bazuar në kuotat e lejuara për çlirimin e gazeve serrë, ose në përgjithësi paraqitjen e librit të porosive në dispozicion të pjesëmarrësve të tregut dhe hiqen përpara se të ekzekutohen;
 - f. shkalla në të cilën jepen urdhra për tregtim ose transaksionet janë ndërmarrë në ose rreth një kohe specifike kur llogariten çmimet e referencës, çmimet e shlyerjes dhe vlerësimet dhe çojnë në ndryshime çmimesh që kanë një efekt në çmime dhe vlerësime të tilla.
4. Në zbatim të pikës 1, shkronja (b) të këtij neni dhe pa cenuar format e sjelljes të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, treguesit e mëposhtëm jo shterues, të cilët nuk do të konsiderohen domosdoshmërisht, në vetvete, që përbëjnë manipulim tregu, duhet të merren parasysh kur transaksionet ose urdhrat për tregtim shqyrtohen nga pjesëmarrësit e tregut dhe autoritetet kompetente:
- a. nëse urdhrat për tregti, të dhënat ose transaksionet e ndërmarra nga persona janë paraprirë ose pasuar nga shpërndarja e informacionit të rremë ose mashtrues/keqorientues nga të njëjtët persona ose nga persona të lidhur me ta;
 - b. nëse janë dhënë urdhra për tregtim ose janë ndërmarrë transaksione nga persona përpara ose pasi të njëjtët persona ose persona të lidhur me ta, prodhojnë ose shpërndajnë rekomandime investimi të cilat janë të gabuara, të njëanshme ose të ndikuara në mënyrë të dukshme nga interesi material.
5. Përveç parashikimeve në pikat 1 deri në 4 të këtij neni, treguesit jo shterues të përkrahur në “Shtojcën II”, do të merren parasysh kur transaksionet ose urdhrat për tregtim të shqyrtohen nga pjesëmarrësit e tregut dhe Autoriteti.

Neni 21

Praktikat e pranuar të tregut

1. Ndalimi sipas nenit 23 të kësaj Rregulloreje nuk zbatohet për aktivitetet e parashikuara në nenin 20, pika 1, shkronja (a) të kësaj Rregulloreje, me kusht që personi që kryen një transaksion, vendos një urdhër për tregtim ose angazhohet në çfarëdo sjelljesh të tjera, të vërtetojë se transaksioni, urdhëri ose sjellja e tillë është kryer për arsye legjitime dhe është në përputhje me një praktikë të pranuar të tregut, siç përcaktohet në përputhje me këtë dispozitë.
2. Autoriteti mund të krijojë një praktikë të pranuar tregu, duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme:
 - a. nëse praktika e tregut siguron një nivel të konsiderueshëm transparence ndaj tregut;
 - b. nëse praktika e tregut siguron një shkallë të lartë garancie për funksionimin e forcave të tregut dhe ndërveprimin e duhur të forcave të ofertës dhe kërkesës;
 - c. nëse praktika e tregut ka një ndikim pozitiv në likuiditetin dhe eficiencën e tregut;

- ç. nëse praktika e tregut merr në konsideratë mekanizmin e tregtimit të tregut përkatës dhe u mundëson pjesëmarrësve të tregut të reagojnë siç duhet dhe në kohën e duhur ndaj situatës së re të tregut, të krijuar nga kjo praktikë;
 - d. karakteristikat strukturore të tregut përkatës, ndër të tjera, nëse ai është i rregulluar apo jo, llojet e instrumenteve financiare që tregtohen dhe llojin e pjesëmarrësve në treg, duke përfshirë shtrirjen e pjesëmarrjes së investitorëve joprofesionistë në tregun përkatës.
3. Praktika e tregut e përcaktuar nga Autoriteti si praktikë e pranuar në treg, nuk do të zbatohet në tregje të tjera jashtë Republikës së Shqipërisë, përveç rasteve kur Autoritetet kompetente të vendeve të tjera e pranojnë këtë praktikë, në përputhje me këtë dispozitë.
 4. Praktika e tregut e njohur si praktikë e pranuar tregu nga Autoritetet kompetente në tregje të tjera jashtë Republikës së Shqipërisë, nuk është e zbatueshme brenda Republikës së Shqipërisë, përveç rastit kur Autoriteti bën njohjen e saj si praktikë e pranuar brenda Republikës së Shqipërisë në përputhje me këtë dispozitë.
 5. Shtojca III e kësaj Rregulloreje përcakton kriteret, procedurën dhe kërkesat për krijimin e një praktike të pranuar tregu dhe kërkesat për ruajtjen e saj, përfundimin, ose modifikimin e kushteve për pranimin e saj.

Neni 22

Ndalimi i tregtimit të bazuar në informacion të privilegjuar dhe i njoftimit të paligjshëm të informacionit të privilegjuar

Asnjë person nuk duhet të:

1. Angazhohet ose përpiqet të angazhohet në tregtimin e bazuar në informacion të privilegjuar
2. Rekomandojë që një person tjetër të angazhohet në tregtim bazuar në informacion të privilegjuar, ose të shtyjë një person tjetër të angazhohet në tregtimin e bazuar në informacion të privilegjuar;
3. Të japë në mënyrë të paligjshme informacion të privilegjuar.

Neni 23

Ndalimi i manipulimit të tregut

Asnjë person nuk duhet të përfshihet ose të përpiqet të përfshihet në manipulimin e tregut.

Neni 24

Parandalimi dhe zbulimi i abuzimit në treg

1. Operatorët e tregut dhe shoqëritë komisionere që operojnë një vend tregtimi, duhet të krijojnë dhe mbajnë rregulla, sisteme dhe procedura efikase që synojnë parandalimin dhe zbulimin e tregtimit të bazuar në informacion të privilegjuar, manipulimin e tregut dhe tentativën për tregtim të bazuar në informacion të privilegjuar dhe manipulim tregu.

Personat e përmendur më sipër duhet t'i raportojnë pa vonesë Autoritetit urdhrat dhe transaksionet, përfshirë çdo anulim ose modifikim të tyre, që mund të përbëjë tregtim të bazuar në informacion të privilegjuar, manipulim tregu ose tentativë për tregtim të bazuar në informacion të privilegjuar, apo tentativë për manipulim të tregut.

2. Çdo person që organizon ose ekzekuton në mënyrë profesionale transaksione, duhet të ketë dhe të mbajë rregulla, sisteme dhe procedura efikase, për të zbuluar dhe raportuar urdhra dhe transaksione të dyshimta.
3. Kur personi i përmendur në pikën 2 të këtij neni, ka dyshim të arsyeshëm se një urdhër ose transaksion në çfarëdo instrumenti financiar, qoftë i vendosur apo ekzekutuar brenda apo jashtë një vendi tregtimi, mund të përbëjë tregtim të bazuar në informacion të privilegjuar, manipulim tregu ose tentativë për tregtim bazuar në informacion të privilegjuar ose tentativë për manipulim tregu, personi duhet të njoftojë Autoritetin pa vonesë, duke përdorur Modelin e Transaksioneve të Dyshimta dhe Raporteve të Urdhrave (STOR) në Shtojcën IV.
4. Të dhënat sipas pikës 3 të kësaj dispozite, do të mbahen të paktën për 5 vjet.

KREU V

KËRKESA PËR NJOFTIM

Neni 25

Bërja publike e informacionit të privilegjuar

1. Emetuesi duhet të informojë publikun menjëherë për informacionin e privilegjuar sipas tabelës në “Shtojcën V”, që ka të bëjë drejtpërdrejtë me atë emetues.

Emetuesi duhet të sigurojë se informacioni i privilegjuar do të bëhet publik në një mënyrë që mundëson akses të shpejtë dhe vlerësim të plotë, korrekt dhe në kohë, të informacionit nga publiku. Emetuesi nuk duhet të kombinojë njoftimin e informacionit të privilegjuar për publikun, me marketingun e aktiviteteve të tij. Emetuesi publikon dhe mban në faqen e tij të internetit për një periudhë prej të paktën pesë vjetësh, të gjitha informacionet e privilegjuara që kërkohet të njoftohen publikisht.

Ky nen zbatohet për emetuesit që kanë kërkuar ose miratuar pranimin e instrumenteve të tyre financiare për tregtimin në një treg të rregulluar në Republikën e Shqipërisë.

2. Pjesëmarrësi i tregut të kuotave të lejuara për çlirimin e gazeve serrë duhet të njoftojë publikisht, në mënyrë efikase dhe në kohën e duhur informacionin e privilegjuar në lidhje me kuotat e lejuara për çlirimin e gazeve serrë që ai mban në lidhje me biznesin e tij, duke përfshirë aktivitetet e aviacionit që zotëron ose kontrollon pjesëmarrësi në fjalë, ose ndërmarrja e tij mëmë ose ndërmarrja e lidhur ose për çështjet operative për të cilat pjesëmarrësi, ose ndërmarrja e tij mëmë ose sipërmarrja e lidhur është përgjegjëse, tërësisht ose pjesërisht. Në lidhje me instalimet, një njoftim i tillë do të përfshijë informacione të rëndësishme për kapacitetin dhe përdorimin e instalimeve, duke përfshirë mosdisponueshmërinë e planifikuar ose të paplanifikuar të instalimeve të tilla.

Parashikimi i mësipërm nuk do të zbatohet për një pjesëmarrës në tregun e kuotave të lejuara për çlirimin e gazeve serrë, ku instalimet ose aktivitetet e aviacionit që ai zotëron, kontrollojnë ose është përgjegjës, në vitin paraardhës kanë pasur emetime që nuk e kalojnë një prag minimal të ekuivalentit të dioksidit të karbonit dhe, kur ato kryejnë aktivitete djegieje, kanë pasur një input termik të vlerësuar që nuk e kalon pragun minimal.

3. Emetuesi ose pjesëmarrësi në treg i kuotave të lejuara për çlirimin e gazeve serrë, me përgjegjësinë e tij, mund të vonojë publikimin e informacionit të privilegjuar, me kusht që të plotësohen të gjitha kriteret e mëposhtme:

- a. njoftimi i menjëhershëm mund të cenojë interesat legjitime të emetuesit ose pjesëmarrësit të tregut të kuotave të lejuara për çlirimin e gazeve serrë;
- b. vonesa e njoftimit nuk ka probabilitet të mashtrorj/keqorientorj publikun;
- c. emetuesi ose pjesëmarrësi i tregut të kuotave të lejuara për çlirimin e gazeve serrë mund të sigurojë konfidencialitetin e atij informacioni;

Në rastin e një procesi të stërzgjatur që ndodh në disa faza dhe që synon të sjellë ose që rezultojnë në një rrethanë të veçantë ose një ngjarje të veçantë, emetuesi ose pjesëmarrësi në treg i kuotave të lejuara për çlirimin e gazeve serrë, mund të vonojë me përgjegjësinë e tij njoftimin publik të informacionit të privilegjuar në lidhje me këtë proces, në varësi të shkronjave (a), (b) dhe (c) të cilësuar më sipër.

Kur emetuesi ose pjesëmarrësi i tregut të kuotave të lejuara për çlirimin e gazeve serrë ka vonuar njoftimin e informacionit të privilegjuar sipas kësaj pike, ai duhet të informojë Autoritetin duke përdorur modelin në Shtojcën VI të kësaj Rregulloreje, se njoftimi i informacionit ishte vonuar dhe do të japë një shpjegim me shkrim se si janë plotësuar kushtet e përcaktuara, menjëherë pas publikimit të informacionit.

4. Për të ruajtur stabilitetin e sistemit financiar, emetuesi që është një bankë ose një institucion financiar, me përgjegjësinë e tij mund të vonojë njoftimin publik të informacionit të privilegjuar duke përfshirë informacionin që lidhet me një problem të përkohshëm likuiditeti dhe, në veçanti, nevojën për të marrë ndihmë të përkohshme likuiditeti nga një bankë qendrore ose huadhënës i mundësisë së fundit, me kusht që të plotësohen të gjitha kriteret e mëposhtme:

- a. njoftimi i informacionit të privilegjuar sjell rrezikun e cenimit të stabilitetit financiar të emetuesit dhe të sistemit financiar;
- b. është në interesin publik që të vonohet njoftimi;
- c. mund të sigurohet konfidencialiteti i atij informacioni; dhe
- ç. Autoriteti ka dhënë miratimin për vonesën në bazë të plotësimit të kushteve në pikat (a), (b) dhe (c).

5. Për qëllimet e shkronjave (a) deri (ç) të pikës 4 të këtij neni, emetuesi duhet të njoftojë Autoritetin për qëllimin e tij për të vonuar zbulimin e informacionit të privilegjuar, duke përdorur modelin e “Shtojcës VI” dhe të sigurojë prova se janë plotësuar kushtet e

përcaktuara në shkronjat (a), (b) dhe (c), të pikës 4 të këtij neni. Autoriteti do të konsultohet, sipas rastit, me Bankën e Shqipërisë.

Autoriteti do të sigurojë që zbulimi i informacionit të privilegjuar të vonohet vetëm për një periudhë, siç është e nevojshme për interesin publik. Autoriteti vlerëson të paktën në bazë javore nëse kushtet e përcaktuara në shkronjat (a), (b) dhe (c), të pikës 4 të kësaj dispozite vazhdojnë të përmbushen.

Nëse Autoriteti nuk jep miratimin për vonesën e njoftimit të informacionit të privilegjuar, emetuesi duhet të njoftojë menjëherë informacionin e privilegjuar.

Kjo pikë do të zbatohet për rastet kur emetuesi nuk vendos të shtyjë njoftimin e informacionit të privilegjuar, në përputhje me pikën 4 të kësaj dispozite.

6. Kur zbulimi i informacionit të privilegjuar është vonuar në përputhje me pikat 3 ose 4 të këtij neni dhe konfidencialiteti i atij informacioni të privilegjuar nuk sigurohet më, emetuesi ose pjesëmarrësi i tregut të kuotave të lejuara për çlirimin e gazeve serrë, duhet t'ia njoftojë atë informacion të privilegjuar publikut sa më shpejt të jetë e mundur.

Ky paragraf përfshin situatat kur një thashethem ka të bëjë shprehimisht me informacionin e privilegjuar, njoftimi i të cilit është vonuar në përputhje me pikat 3 ose 4 të këtij neni, kur ky thashethem është mjaftueshëm i saktë për të treguar se konfidencialiteti i atij informacioni nuk është siguruar më gjatë.

7. Kur një emetues ose një pjesëmarrës i tregut të kuotave të lejuara për çlirimin e gazeve serrë, ose një person që vepron në emër ose për llogari të tyre, i jep ndonjë informacion të privilegjuar një pale të tretë në rrjedhën normale të ushtrimit të një veprimtarie, profesioni ose detyrash, siç parashikohet në nenin 18, pika 1 të kësaj Rregulloreje, ata duhet të bëjnë publikimin e plotë dhe efikas të atij informacioni, njëkohësisht në rastin e një zbulimi të qëllimshëm dhe menjëherë në rastin e një zbulimi jo të qëllimshëm. Kjo pikë nuk zbatohet nëse personi që merr informacionin ka detyrimin e konfidencialitetit, pavarësisht nëse një detyrë e tillë bazohet në ligj, në rregullore, në statut ose në një kontratë.

Neni 26

Lista e personave me informacion të privilegjuar

1. Emetuesi ose personi që vepron në emër e për llogari të tij ose çdo shoqëri komisionere që ofron shërbime investimi, apo cilido këshilltar i fushës, harton listën e personave që punojnë për ta me kontratë pune apo në mënyra të tjera, të cilët kanë të drejtë të marrin informacion të privilegjuar që ka lidhje drejtpërdrejt ose tërthorazi me emetuesin, si p.sh kontabilist, këshilltar, agjensi të vlerësimit të kreditit, në mënyrë të rregullt ose rastësore.
2. Emetuesi ose personi, që vepron në emër të tij apo për llogari të tij, përditëson rregullisht listën dhe ia dorëzon atë Autoritetit me kërkesën e tij dhe e mban listën për të paktën pesë vjet nga hartimi ose përditësimi.
3. Lista e personave me informacion të privilegjuar do të përfshijë në përputhje edhe me "Shtojcën VII" të kësaj Rregulloreje të paktën të dhënat: emër dhe mbiemër, datëlindje,

adresën e vendbanimit të përhershëm ose vendbanimit të përkohshëm, nëse ka, të personit që ka akses tek informacionet e privileguara, arsyet e përfshirjes së personit në listë, datën dhe kohën në të cilën ai person mori akses në informacionin e privileguar dhe datën me të cilën është hartuar ose përditësuar lista e personave me informacion të privileguar.

4. Lista e personave me informacion të privileguar do të përditësohet sa herë që ka ndryshim të arsyes së përfshirjes së një personi në listë, sa herë që në listë duhet të shtohet një person i ri dhe sa herë një person, i cili është në listë, nuk ka më të drejtë të aksesojë informacionin e privileguar. Çdo përditësim do të specifikojë datën dhe kohën kur ka ndodhur ndryshimi që ka shkaktuar përditësimin.
5. Personat, të cilët kanë detyrimin të hartojnë listat e personave me informacion të privileguar, ndërmarrin masat e nevojshme për të siguruar që çdo person i përfshirë në listë, i cili ka akses tek informacioni i privileguar, njih detyrimet ligjore e rregullatore dhe është i vetëdijshëm për penaltitetet që shoqërojnë shpërdorimin ose përhapjen e gabuar të këtyre informacioneve.
6. Kur një person tjetër që vepron në emër ose për llogari të emetuesit merr përsipër detyrën e hartimit dhe përditësimit të listës së personave me informacion të privileguar, emetuesi mbetet plotësisht përgjegjës për respektimin e këtij neni. Emetuesi duhet të ketë gjithmonë të drejtën e aksesit në listën e personave me informacion të privileguar.
7. Kjo dispozitë zbatohet për emetuesit që kanë kërkuar ose i'u është miratuar pranimi për tregtim i instrumenteve të tyre financiare në një treg të rregulluar në Republikën e Shqipërisë.
8. Pikat 1 deri në 6 të këtij neni zbatohen edhe për:
 - a. pjesëmarrësit e tregut të kuotave të lejuara për çlirimin e gazeve serrë, në lidhje me informacionin e privileguar për këto kuota, që lind në lidhje me veprimet fizike të atij pjesëmarrësi të tregut të kuotave të lejuara;
 - b. çdo platformë ankandi, pjesëmarrës në ankand dhe monitorues ankandi, në lidhje me ankandet e kuotave të lejuara për çlirimin e gazeve serrë, ose produkteve të tjera të nxjerra në ankand të bazuara në to.

Neni 27

Transaksionet e kryera nga organet drejtuese

1. Personat që kanë përgjegjësi menaxheriale, si dhe personat e lidhur ngushtë me ta, duhet të njoftojnë emetuesin ose pjesëmarrësin e tregut të kuotave të lejuara për çlirimin e gazeve serrë, si dhe Autoritetin:
 - a. në lidhje me emetuesit, për çdo transaksion të kryer për llogari të tyre në lidhje me aksionet ose instrumentet e borxhit të atij emetuesi ose me derivativët ose instrumentet e tjerë financiarë të lidhur me to;
 - b. në lidhje me pjesëmarrësit e tregut të kuotave të lejuara për çlirimin e gazeve serrë, për çdo transaksion të kryer për llogari të tyre, në lidhje me kuotat e lejuara për çlirimin e

gazeve serë, me produktet e ankandit të bazuara në to ose me derivativët që lidhen me to.

Njoftimi sipas pikës 1 të këtij neni duhet të bëhet menjëherë dhe jo më vonë se tre ditë pune pas datës së transaksionit, duke përdorur modelin në “Shtojcën VIII” të kësaj Rregulloreje.

Kjo pikë zbatohet kur shuma totale e transaksioneve të ketë arritur pragun e përcaktuar në pikat (8) ose (9) të këtij neni, sipas rastit, brenda një viti kalendarik.

2. Të gjitha transaksionet e kryera për llogari të personave të përmendur në pikën (1) të kësaj dispozite, do t'i njoftohen Autoritetit nga këta persona.
3. Emetuesi ose pjesëmarrësi i tregut të kuotave të lejuara për çlirimin e gazeve serë, duhet të sigurojë që informacioni i njoftuar në përputhje me pikën (1) të këtij neni të bëhet publik menjëherë dhe jo më vonë se tre ditë pune pas transaksionit, në një mënyrë që mundëson akses në këtë informacion, në mënyrë jodiskriminuese.

Emetuesi ose pjesëmarrësi i tregut të kuotave të lejuara për çlirimin e gazeve serë, për shpërndarjen efikase të informacionit për publikun, duhet të përdorë media të zgjedhur mbi baza të besueshme dhe të arsyeshme.

Në mënyrë alternative, Autoriteti mund ta bëjë vetë publik informacionin.

4. Ky nen gjen zbatim për emetuesit, të cilët:
 - a. kanë kërkuar ose i'u është miratuar pranimi për tregtim i instrumenteve të tyre financiare në një treg të rregulluar;
 - b. në rastin e një instrumenti të tregtuar vetëm në një PSHT ose një POT, të kenë miratuar tregtimin e instrumenteve të tyre financiare në një PSHT ose një POT, ose të kenë kërkuar pranimin për tregtim të instrumenteve të tyre financiare në një PSHT.
5. Emetuesit dhe pjesëmarrësit e tregut të kuotave të lejuara për çlirimin e gazeve serë, duhet të njoftojnë me shkrim personin me përgjegjësi menaxheriale për detyrimet e tyre sipas këtij neni. Emetuesit dhe pjesëmarrësit e tregut të kuotave të lejuara për çlirimin e gazeve serë, duhet të hartojnë një listë të të gjithë personave që përmbushin përgjegjësi menaxheriale dhe personave të lidhur ngushtë me ta.

Personat që përmbushin përgjegjësi menaxheriale njoftojnë me shkrim personat e lidhur ngushtë me ta për detyrimet e tyre sipas këtij neni dhe ruajnë një kopje të këtij njoftimi.

6. Njoftimi për transaksionet e parashikuara në pikën (1) të këtij neni, përmban informacionin si vijon:
 - a. emrin e personit;
 - b. arsyen e njoftimit;
 - c. emrin e emetuesit përkatës ose pjesëmarrësit të tregut të kuotave të lejuara për çlirimin e gazeve;

- ç. një përshkrim dhe identifikuesin e instrumentit financiar;
 - d. natyrën e transaksionit (p.sh. blerjen ose likuidimin/shitjen), duke treguar nëse transaksioni ka të bëjë me ushtrimin e programeve të opsioneve në aksione, ose me shembujt specifikë të përcaktuar në pikën 7 të këtij neni;
 - e. datën dhe vendin e transaksionit;
 - f. çmimin dhe vëllimin e transaksionit. Në rastin e një kolaterali/pengu, kushtet e të cilit parashikojnë ndryshimin e vlerës së tij, kjo duhet të zbulohet së bashku me vlerën e tij në datën e kolateralit/pengut.
7. Për qëllim të këtij neni, transaksionet që duhet të njoftohen përfshijnë gjithashtu:
- a. vendosjen peng/kolateral ose huadhënien e instrumenteve financiare nga ose në emër të një personi me përgjegjësi menaxheriale, ose një personi të lidhur ngushtë me një person të tillë, siç parashikohet në pikën 1 të këtij neni;
 - b. transaksionet e ndërmarra nga persona që organizojnë ose ekzekutojnë në mënyrë profesionale transaksione, ose nga një person tjetër në emër të një personi që përmbush përgjegjësi menaxheriale, ose një personi të lidhur ngushtë me një person të tillë, siç parashikohet në pikën 1 të këtij neni, përfshirë rastin kur ushtrohet diskrecion;
 - c. transaksionet e kryera sipas një police sigurimi të jetës, ku:
 - i. mbajtësi i policës është personi që përmbush përgjegjësi menaxheriale, ose një person i lidhur ngushtë me një person të tillë, sipas pikës 1 të këtij neni;
 - ii. rreziku i investimit përballohet nga mbajtësi i policës;
 - iii. mbajtësi i policës ka kompetencën ose diskrecionin për të marrë vendime investimi në lidhje me instrumente specifike në atë policë sigurimi jete, ose për të ekzekutuar transaksione në lidhje me instrumente specifike për atë policë sigurimi jete.

Për qëllimet e shkronjës (a), një /kolateral//pengu, ose një interes i ngjashëm sigurimi, i instrumenteve financiare në lidhje me depozitimin e instrumenteve financiare në një llogari kujdestarie nuk ka nevojë të njoftohet, përveçse nëse dhe deri në atë kohë që ky peng/kolateral ose interesa të tjera sigurie janë caktuar për të siguruar një facilitet të caktuar kreditimi.

Përderisa një mbajtësi të policës së një kontrate sigurimi i kërkohet të njoftojë transaksionet sipas kësaj pike, detyrimi për të njoftuar nuk i takon shoqërisë së sigurimit.

- 8. Pika (1) e kësaj dispozite do të zbatohet për çdo transaksion vijues pasi të arrihet shuma totale prej 600,000 ALL brenda një viti kalendarik. Pragu prej 600,000 ALL do të llogaritet duke shtuar të gjitha transaksionet (jo si transaksione të netuara) nga pika (1) e këtij neni.
- 9. Autoriteti mund të vendosë rritjen e kufirit të përcaktuar në pikën (8) të këtij neni në 2,400,000 ALL, duke iu referuar specifikisht kushteve të tregut, për të miratuar pragun më

të lartë përpara aplikimit të tij. Autoriteti publikon në faqen e tij të internetit listën e pragjeve që zbatohen në përputhje me këtë nen dhe arsyetimet e dhëna nga Autoriteti për këto pragje.

10. Ky nen do të zbatohet gjithashtu për transaksionet nga personat që përmbushin përgjegjësi menaxheriale brenda çdo platforme ankandi, drejtuesi ankandi dhe monitoruesi ankandi të përfshirë në ankande dhe për personat e lidhur ngushtë me persona të tillë, për aq sa transaksionet e tyre përfshijnë kuota të lejuara për çlirimin e gazeve, derivate të tyre ose produkte të ankandeve bazuar në to. Këta persona duhet t'i njoftojnë transaksionet e tyre në platformat e ankandeve, drejtuesve të ankandeve dhe monitoruesve të ankandeve, sipas rastit, dhe Autoritetit ku është regjistruar platforma e ankandit, drejtuesi i ankandit ose monitoruesi i ankandit, sipas rastit. Informacioni që njoftohet do të bëhet publik nga platformat e ankandeve, drejtuesit e ankandeve, monitoruesit e ankandeve ose Autoriteti, në përputhje me pikën (3) të këtij neni.
11. Personi që përmbush përgjegjësi menaxheriale brenda një emetuesi nuk duhet të kryejë asnjë transaksion për llogarinë e tij ose për llogari të një pale të tretë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në lidhje me aksionet ose instrumentet e borxhit të emetuesit ose me derivativët ose instrumentet e tjera financiare të lidhura me to, gjatë një periudhe të mbyllur prej 30 ditësh kalendarike, përpara shpalljes së një raporti financiar të ndërmjetëm ose të një raporti fundviti, të cilin emetuesi është i detyruar ta bëjë publik sipas rregullave të vendit të tregtimit ku aksionet e emetuesit pranojnë për tregtim.
12. Emetuesi mund të lejojë një person pranë tij që përmbush përgjegjësi menaxheriale, të tregtojë për llogari të tij ose për llogari të një pale të tretë gjatë një periudhe të mbyllur, siç parashikohet në pikën (10) të këtij neni, ose:
 - a. rast pas rasti për shkak të ekzistencës së rrethanave të jashtëzakonshme, të tilla si vështirësi të rënda/mëdha financiare, të cilat kërkojnë shitjen e menjëhershme të aksioneve;
 - b. për shkak të karakteristikave të tregtimit të përfshirë për transaksionet e kryera, ose të lidhura me një aksion punonjësi ose skemë kursimi, kualifikimin ose të drejtën e aksioneve, ose transaksionet ku interesi përfitues në vlerën përkatëse nuk ndryshon.

Neni 28

Rekomandime për investime dhe statistika

1. Personat që përgatisin ose shpërndajnë rekomandime/këshillime investimi ose informacione të tjera, që rekomandojnë ose sugjerojnë një strategji investimi, duhet të tregojnë kujdes mbi baza të arsyeshme për të siguruar që ky informacion të paraqitet objektivisht dhe të zbulojnë interesat e tyre, ose të tregojnë konfliktet e interesit në lidhje me instrumentet financiare, me të cilat lidhet ai informacion.
2. Institucionet publike që shpërndajnë statistika ose parashikime që mund të kenë një efekt të rëndësishëm në tregjet financiare, i shpërndajnë ato në mënyrë objektive dhe transparente.

Neni 29

Zbulimi ose shpërndarja e informacionit në media

Për qëllim të nenit 18, nenit 20, pika 1, shkronja (c) dhe nenit 28 të kësaj Rregulloreje, kur informacioni bëhet i njohur ose shpërndahet dhe kur rekomandimet përgatiten ose shpërndahen për qëllime gazetarie ose forma të tjera shprehjeje në media, zbulimi ose shpërndarja e informacionit vlerësohet duke marrë parasysh rregullat që rregullojnë lirinë e shtypit dhe lirinë e shprehjes në media të tjera dhe rregullat ose kodet që rregullojnë profesionin e gazetarit në Republikën e Shqipërisë, përveç rasteve kur:

- a. personat në fjalë, ose personat e lidhur ngushtë me ta, nxjerrin, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një avantazh ose përfitime nga zbulimi ose shpërndarja e informacionit në fjalë;
- b. zbulimi ose shpërndarja është bërë me qëllimin për të keqinformuar/keqorientuar tregun në lidhje me ofertën, kërkesën ose çmimin e instrumenteve financiare.

KREU IV

SEKRETI PROFESIONAL DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE

Neni 30

Sekreti profesional

1. Çdo informacion konfidencial i marrë, i shkëmbyer ose i transmetuar në përputhje me këtë Rregullore do t'i nënshtrohet kushteve të sekretit profesional të përcaktuara në pikat (2) dhe (3) të këtij neni.
2. Të gjitha informacionet e shkëmbyera ndërmjet Autoritetit, sipas kësaj Rregulloreje, që kanë të bëjnë me kushtet e biznesit ose operacionale dhe çështje të tjera ekonomike ose personale, do të konsiderohen konfidenciale dhe do t'u nënshtrohen kritereve të sekretit profesional, përveç rasteve kur Autoriteti deklaron në kohën e komunikimit se një informacion i tillë mund të zbulohet ose një zbulim i tillë është i nevojshëm për procedurat ligjore.
3. Detyrimi i sekretit profesional zbatohet për të gjithë personat që punojnë ose që kanë punuar për Autoritetin, ose për çdo autoritet ose sipërmarrje tregu, të cilit Autoriteti i ka deleguar kompetencat e tij, duke përfshirë audituesit dhe ekspertët e kontraktuar nga Autoriteti. Informacioni që duhet të jetë sekret profesional nuk mund t'i jepet asnjë personi ose autoriteti tjetër, përveçse në bazë të dispozitave të parashikuara nga Ligji.

Neni 31

Mbrojtja e të dhënave

Autoriteti kryen detyrat e tij për qëllimet e kësaj Rregulloreje, në përputhje me ligjet në fuqi në Republikën e Shqipërisë, për sa i përket përpunimit të të dhënave personale.

Të dhënat personale do të ruhen për një periudhë maksimale prej pesë vjetësh.

KREU V

MASAT DHE SANKSIONET ADMINISTRATIVE

Neni 32

Ushtrimi i kompetencave mbikëqyrëse dhe kompetencave për vendosjen e sanksioneve

Autoriteti, kur përcakton llojin dhe nivelin e sanksioneve administrative dhe masave të tjera administrative në përputhje me Ligjin, merr parasysh të gjitha rrethanat përkatëse, duke përfshirë, kur është e nevojshme:

1. shkallën dhe kohëzgjatjen e shkeljes;
2. shkallën e përgjegjësisë së personit përgjegjës për shkeljen;
3. fuqinë financiare të personit përgjegjës për shkeljen, siç tregohet, për shembull, nga qarkullimi total i një personi juridik ose nga të ardhurat vjetore të një personi fizik;
4. rëndësinë e fitimeve të përfituara ose humbjeve të shmangura nga personi përgjegjës për shkeljen, për aq sa mund të përcaktohet;
5. nivelin e bashkëpunimit të personit përgjegjës për shkeljen me autoritetin kompetent, pa cënuar nevojën për të siguruar heqjen e fitimeve të përfituara ose humbjet e shmangura nga ai person;
6. shkeljet e mëparshme të kryera nga personi përgjegjës për shkeljen;
7. masat e marra nga personi përgjegjës për shkeljen për të parandaluar përsëritjen e saj.

Neni 33

Raportimi i shkeljeve

1. Autoriteti duhet të krijojë një mekanizëm efikas për të mundësuar raportimin e shkeljeve aktuale ose të mundshme të kësaj Rregulloreje.
2. Mekanizmat e parashikuar në pikën (1) të kësaj dispozite përfshijnë të paktën:
 - a. procedurat specifike për marrjen e raporteve të shkeljeve dhe ndjekjen e tyre, duke përfshirë krijimin e kanaleve të sigurta të komunikimit për raporte të tilla;
 - b. mbrojtjen e duhur për personat që punojnë sipas një kontrate pune, të cilët raportojnë shkelje ose akuzohen për shkelje, kundër hakmarrjes, diskriminimit ose të llojeve të tjera të trajtimit të padrejtë;
 - c. mbrojtjen e të dhënave personale, si të personit që raporton shkeljen, ashtu edhe të personit fizik që pretendohet se ka kryer shkeljen, duke përfshirë mbrojtjen në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit të identitetit të tyre, në të gjitha fazat e procedurës, pa cënuar

zbulimin e informacionit që kërkohet nga ligji kombëtar në kontekstin e hetimeve ose procedurave gjyqësore të mëvonshme.

3. Punëdhënësit të cilët kryejnë veprimtari që rregullohen me rregullore për shërbimet financiare duhet të kenë në zbatim procedura të brendshme që punonjësit e tyre të raportojnë shkeljet e kësaj Rregulloreje.
4. Autoriteti mund t'u japë stimuj financiarë personave që ofrojnë informacion përkatës për shkelje të mundshme të kësaj Rregulloreje, kur këta persona nuk kanë detyrime ligjore ose kontraktuale të mëparshme për të raportuar një informacion të tillë, si dhe kur informacioni i dhënë është i ri dhe rezulton në vendosjen e një sanksioni administrativ ose penal, ose marrjen e një mase tjetër administrative, për shkelje të kësaj Rregulloreje.

KREU VI

DISPOZITA E FUNDIT

Neni 34

Hyrja në fuqi dhe zbatimi

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë.

SHTOJCA I – LISTA JOSHTERUESE E NGJARJEVE QË MUND TË PËRBËJNË INFORMACION TË PRIVILEGJUAR

Informacionet e privileguara të listuara përfaqësojnë një listë jo shteruese dhe thjesht treguese të ngjarjeve të llojit që mund të përbëjnë informacion të privilegjuar. Fakti që një ngjarje nuk shfaqet në listë nuk do të thotë se nuk mund të jetë informacion i privilegjuar, as fakti që një ngjarje përfshihet në listë nuk do të thotë se automatikisht do të jetë informacion i privilegjuar. Për vlerësimin nëse Informacioni konsiderohet i privilegjuar vetëm nëse ai ka efekte materiale në mënyrë të mjaftueshme, si dhe duhet marrë në konsideratë rrethanat specifike. Për më tepër, janë rrethanat specifike të secilit rast që duhet të merren në konsideratë.

1. Informacioni që ka të bëjë drejtpërdrejtë me emetuesin:
 - a. Performanca e aktivitetit të biznesit;
 - b. Ndryshimet në pjesëmarrjen influencuese dhe në marrëveshjet e pjesëmarrjes influencuese;
 - c. Ndryshimet në organet drejtuese dhe mbikëqyrëse ;
 - ç. Ndryshimet e audituesve ose çdo informacion tjetër në lidhje me veprimtarinë e audituesve;
 - d. Veprimet që lidhen me kapitalin ose emetimin e titujve të borxhit ose kolateralin/pengun për blerjen ose nënshkrimin e titujve;
 - e. Vendimet për rritjen ose uljen e kapitalit aksionar;
 - f. Bashkimet, ndarjet dhe shkëputjet;
 - g. Blerja ose likuidimi/shitja e interesave të kapitalit neto ose aktiveve të tjera kryesore ose degëve të aktivitetit të shoqërisë;
 - h. Ristrukturimet ose riorganizimet që kanë një efekt në aktivet dhe detyrimet, pozicionin financiar ose fitimet dhe humbjet e emetuesit;
 - i. Vendimet në lidhje me programet e ri-blejjes ose transaksionet në instrumente të tjera financiare të listuara;
 - j. Ndryshimet në të drejtat e klasës së aksioneve të listuara të emetuesit;
 - k. Paraqitja e kërkesave për falimentim ose lëshimi i urdhrave për procedurë falimentimi;
 - l. Mosmarrëveshjet ligjore;
 - m. Revokimi ose anulimi i linjave të kredisë nga një ose më shumë banka;
 - n. Shpërbërja ose verifikimi i një shkakut të shpërbërjes;

- o. Ndryshimet në vlerën e aseteve;
 - p. Falimentimi i debitorëve përkatës;
 - q. Ulja e vlerës së pronave të paluajtshme;
 - r. Shkatërrimi fizik i mallrave të pasiguruar;
 - s. Licencat e reja, patentat, markat e regjistruara tregtare;
 - t. Ulja ose rritja e vlerës së instrumenteve financiare në portofol;
 - u. Ulja e vlerës së patentave ose të drejtave ose aktiveve jo-materiale për shkak të inovacionit të tregut;
 - v. Marrja e ofertave për blerje të aseteve përkatëse;
 - w. Produkte ose procese novatore;
 - x. Përgjegjësia për produktin ose rastet e dëmeve mjedisore;
 - y. Ndryshimet në fitimet ose humbjet e pritshme;
 - z. Urdhrat e marrë nga klientët, anulimi i tyre ose ndryshime të rëndësishme;
 - aa. Tërheqja ose hyrja në fusha të reja të biznesit kryesor;
 - bb. Ndryshimet në politikën e investimit të emetuesit;
 - cc. Data e ish-dividendit, ndryshimet në datën e pagesës së dividendit dhe shumën e dividendit; ndryshimet në politikën e dividendit.
2. Informacioni që ka ndikim jo të drejtpërdrejtë tek emetuesi.
- a. Të dhënat dhe statistikat e publikuara nga institucionet publike që shpërndajnë statistika;
 - b. Publikimi i ardhshëm i raporteve të agjencive të vlerësimit;
 - c. Publikimi i ardhshëm i kërkimeve, rekomandimeve ose sugjerimeve në lidhje me vlerën e instrumenteve financiare të listuara;
 - ç. Vendimet e bankës qendrore në lidhje me normat e interesit;
 - d. Vendimet e qeverisë në lidhje me tatimin, rregullimin e industrisë, menaxhimin e borxhit, etj.;
 - e. Vendimet në lidhje me ndryshimet në rregullat e qeverisjes së indekseve të tregut, si dhe veçanërisht në lidhje me përbërjen e tyre;
 - f. Vendimet e tregjeve të rregulluara dhe të parregulluara në lidhje me rregullat që rregullojnë këto tregje;

- g. Vendimet e autoriteteve të konkurrencës dhe tregut në lidhje me kompanitë e listuara;
- h. Urdhrat përkatës nga organet qeveritare, autoritetet rajonale ose lokale ose organizata të tjera publike;
- i. Një ndryshim në mënyrën e tregtimit (p.sh., informacion në lidhje me dijeninë se instrumentet financiare të një emetuesi do të tregtohen në një segment tjetër tregu: p.sh. ndryshimi nga tregtimi i vazhdueshëm në tregtimin me ankand);
- j. një ndryshim i krijuesit të tregut ose kushteve të marrëveshjes.

SHTOJCA II – Treguesit e sjelljes manipuluese në lidhje me sinjalet e rreme ose mashtruese/keqorientuese dhe me sigurimin e çmimeve

A. Treguesit e sjelljes manipuluese në lidhje me sinjalet e rreme ose mashtruese/keqorientuese dhe me sigurimin e çmimeve

Treguesit e mëposhtëm jo shterues, të cilët nuk do të konsiderohen domosdoshmërisht, në vetvete, se përbëjnë manipulim tregu, do të merren parasysh kur transaksionet ose urdhrat për tregtim të shqyrtohen nga pjesëmarrësit e tregut dhe Autoriteti:

- a. shkalla në të cilën urdhrat e dhënë për tregtim ose transaksionet e ndërmarra, përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të vëllimit ditor të transaksioneve në instrumentin financiar përkatës, kontratën e lidhur me mallra ose produktin e nxjerrë në ankand bazuar në kuotat e lejuara për çlirimin e gazeve serrë , veçanërisht kur këto aktivitete çojnë në një ndryshim të rëndësishëm në çmimet e tyre;
- b. shkalla në të cilën urdhrat e dhënë për tregtim ose transaksionet e ndërmarra nga persona me një pozicion të rëndësishëm blerjeje ose shitjeje në një instrument financiar, një kontratë të lidhur me mallra, ose një produkt të nxjerrë në ankand bazuar në kuotat e lejuara për çlirimin e gazeve serrë , çojnë në ndryshime të rëndësishme në çmimin e atij instrumenti financiar, kontratës së lidhur me mallra, ose produktit të nxjerrë në ankand bazuar në kuotat e lejuara për çlirimin e gazeve serrë
- c. nëse transaksionet e ndërmarra nuk çojnë në asnjë ndryshim në pronësinë përfituese të një instrumenti financiar, të një kontrate të lidhur me mallra, ose të një produkti të nxjerrë në ankand në kuotat e lejuara për çlirimin e gazeve serrë ;
- ç. shkalla në të cilën urdhrat për tregtim të dhënë ose transaksionet e ndërmarra ose urdhrat e anuluar përfshijnë ndryshimin e pozicionit në një periudhë të shkurtër dhe përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të vëllimit ditor të transaksioneve në instrumentin financiar përkatës, në kontratën e lidhur me mallra, ose një produkt të nxjerrë në ankand bazuar në kuotat e lejuara për çlirimin e gazeve serrë , si dhe mund të shoqërohet me ndryshime të rëndësishme në çmimin e tyre;
- d. shkalla në të cilën urdhrat e dhënë për tregtim ose transaksionet e ndërmarra përqendrohen brenda një periudhe të shkurtër kohore në sesionin e tregtimit dhe çojnë në një ndryshim çmimi, i cili ë pas është në krah të kundërt;
- e. shkalla në të cilën urdhrat për tregtimin e dhënë ndryshojnë përfaqësimin e ofertës më të mirë ose çmimet e ofruara për një instrument financiar, një kontratë të lidhur me mallra, ose një produkt të nxjerrë në ankand bazuar në kuotat e lejuara për çlirimin e gazeve serrë , ose në përgjithësi paraqitjen e librit të urdhrave në dispozicion të pjesëmarrësve të tregut dhe hiqen përpara se të ekzekutohen; dhe
- f. shkalla në të cilën jepen urdhra për tregtim ose transaksionet janë ndërmarrë në ose rreth një kohe specifike kur llogariten çmimet e referencës, çmimet e shlyerjes dhe vlerësimet dhe çojnë në ndryshime çmimesh që kanë një efekt në çmime dhe vlerësime të tilla.

B. Treguesit e sjelljes manipuluese në lidhje me përdorimin e një pajisjeje fiktive ose çdo forme tjetër mashtrimi ose falsiteti.

Treguesit e mëposhtëm jo shterues, të cilët nuk do të konsiderohen domosdoshmërisht, në vetvete, se përbëjnë manipulim tregu, do të merren parasysh kur transaksionet ose urdhrat për tregtim të shqyrtohen nga pjesëmarrësit e tregut dhe Autoriteti:

- a. nëse urdhrat e dhënë për tregtim ose transaksionet e ndërmarra nga persona janë paraprirë ose pasuar nga shpërndarja e informacionit të rremë ose mashtrues/keqorientues nga të njëjtët persona ose nga persona të lidhur me ta; dhe
- b. nëse janë dhënë urdhra për tregtim ose janë ndërmarrë transaksione nga persona përpara ose pasi të njëjtët persona, ose persona të lidhur me ta, nxjerrin ose shpërndajnë rekomandime/këshillim investimi të cilat janë të gabuara, të njëanshme ose të ndikuara në mënyrë të dukshme nga interesi material.

SHTOJCA III – KRITERET, PROCEDURA DHE KËRKESAT PËR KRIJIMIN E NJË PRAKTIKE TË PRANUAR TREGU DHE KRITERET PËR RUAJTJEN, DHËNIEN FUND OSE MODIFIKIMIN E KUSHTEVE PËR PRANIMIN E SAJ

Seksioni 1

Krijimi i një praktike të pranuar tregu

Neni 1

Kritere të përgjithshme

1. Përpara krijimit të një praktike tregu si një *praktikë të pranuar tregu* (PPT), Autoriteti duhet të:
 - a. vlerësojë praktikën e tregut kundrejt secilit prej kritereve të përcaktuara në nenin 21 (2) të kësaj rregulloreje dhe të specifikuar më tej në Seksionin 2 të kësaj shtojce;
 - b. konsultohet sipas rastit me organet përkatëse, duke përfshirë, minimalisht, përfaqësuesit e emetuesve, shoqërive komisionere, bankave, investitorëve, pjesëmarrësve të tregut të kuotave të lejuara për çlirimin e gazeve serrë , operatorëve të tregut që operojnë një platformë shumëpalëshe tregtimi (PSHT) ose një platformë të organizuar tregtimi (POT) dhe operatorët e një tregu të rregulluar, mbi përshtatshmërinë e krijimit të një praktike tregu si PPT.
2. Autoriteti që synon të krijojë një praktikë tregu si PPT duhet të njoftojë autoritetet e tjera kompetente jashtë Republikës së Shqipërisë për këtë synim, në përputhje me procedurën e përcaktuar në seksionin 3 të kësaj Shtojce, duke përdorur modelin e përcaktuar në tabelën 1.
3. Kur Autoriteti vendos në zbatim një praktikë tregu si një PPT në përputhje me nenin 21 të kësaj rregulloreje dhe me këtë rregullore, publikon në faqen e internetit vendimin që përcakton praktikën e tregut si një PPT dhe një përshkrim të PPT-së përkatëse, në përputhje me modelin e përcaktuar në këtë Shtojcë, duke përfshirë informacionin e mëposhtëm:
 - a. një përshkrim të llojeve të personave që mund të kryejnë PPT-në;
 - b. një përshkrim të llojeve të personit ose të një grupi personash që mund të përfitojnë nga performanca e PPT-së, qoftë duke e kryer atë drejtpërdrejt ose nëpërmjet emërimit të një personi tjetër që kryen PPT-në (“përfituesi”);
 - c. një përshkrim të llojit të instrumentit financiar me të cilin lidhet PPT-ja;
 - ç. një tregues nëse PPT-ja mund të kryhet për një periudhë të caktuar kohe dhe një përshkrim të situatave ose kushteve që çojnë në një ndërprerje, pezullim ose përfundim të përkohshëm të praktikës.

Personat e parashikuar në shkronjën (a) të kësaj pike, janë përgjegjës për çdo vendim tregtimi, duke përfshirë, dorëzimin e një urdhri, anulimin ose modifikimin e një urdhri dhe përfundimin e një transaksioni ose për ekzekutimin e tregimit në lidhje me PPT-në.

SEKSIONI 2

Specifikimi i kritereve që duhen marrë parasysh kur vendosen në zbatim praktikat e pranuar të tregut

Neni 2 Transparenca

1. Në përcaktimin nëse një praktikë tregu mund të krijohet si një PPT dhe nëse ajo përmbush kriterin e përcaktuar në pikën (a) të nenit 21 (2) të kësaj rregulloreje, Autoriteti do të shqyrtojë nëse praktika e tregut siguron se informacioni i mëposhtëm do të bëhet i ditur për publikun:
 - a. përpara se një praktikë tregu të kryhet si një PPT:
 - (i) identitetet e përfituesve dhe të personave që do ta kryejnë atë dhe të atij që është përgjegjës mes tyre për të përmbushur kriteret e transparencës sipas pikave (b) dhe (c) të këtij paragrafi;
 - (ii) identifikimi i instrumenteve financiare në lidhje me të cilat do të zbatohet PPT-ja;
 - (iii) periudha gjatë së cilës do të kryhet PPT-ja dhe situatat ose kushtet që çojnë në ndërprerjen, pezullimin ose përfundimin e përkohshëm të performancës së saj;
 - (iv) identifikimi i vendeve të tregimit në të cilat do të kryhet PPT-ja dhe, kur është e zbatueshme, treguesi i mundësisë për të ekzekutuar transaksione jashtë një vendi tregtimi;
 - (v) referencë për shumat maksimale të keshit dhe për numrin e instrumenteve financiare të alokuara për performancën e PPT-së, nëse është e zbatueshme.
 - b. pasi praktika e tregut kryhet si një PPT:
 - (i) në mënyrë periodike, detaje të aktivitetit tregtar në lidhje me performancën e PPT-së si numri i transaksioneve të kryera, vëllimi i tregtuar, madhësia mesatare e transaksioneve dhe diferencat mesatare të kuotuar (average spreads quoted), çmimet e transaksioneve të kryera;
 - (ii) çdo ndryshim në informacionin e zbuluar më parë mbi PPT-në, duke përfshirë ndryshimet në lidhje me burimet e disponueshme për sa u përket keshit dhe instrumenteve financiare, ndryshimet në identitetin e personave që kryejnë PPT-në dhe çdo ndryshim në shpërndarjen e keshit ose instrumenteve financiare në llogaritë e përfituesit dhe të personave që kryejnë PPT-në.
 - c. kur praktika e tregut pushon realizimin si PPT me iniciativën e personit që e ka kryer atë, të përfituesit ose të të dyve:
 - (i) fakti që performanca e PPT-së ka pushuar;
 - (ii) anjë përkrahje se si është kryer PPT-ja;

- (iii) arsyet ose shkaqet e ndërprerjes së performancës së PPT-së.

Për qëllimet e pikës (b)(i), kur kryhen transaksione të shumta në një seancë të vetme tregtimi, shifrat agregate ditore mund të jenë të pranueshme në lidhje me kategoritë e duhura të informacionit.

2. Në përcaktimin nëse një praktikë tregu mund të krijohet si PPT dhe nëse ajo përmbush kriterin e përcaktuar në pikën (a) të nenit 21 (2) të kësaj rregulloreje, autoritetet kompetente do të shqyrtojnë nëse praktika e tregut siguron që informacioni i mëposhtëm do t'u bëhet me dije atyre:
 - a. përpara se praktika e tregut të kryhet si PPT, marrëveshjet ose kontratat midis përfituesve të identifikuar dhe personave që do të kryejnë praktikën e tregut pasi të krijohen si PPT, kur këto marrëveshje ose kontrata nevojiten për zbatimin e saj;
 - b. pasi praktika e tregut të kryhet si PPT, raportimi periodik tek autoriteti kompetent me detaje në lidhje me transaksionet e kryera dhe për operacionet e çdo marrëveshjeje ose kontrate midis përfituesit dhe personave që realizojnë PPT-në.

Neni 3

Masat mbrojtëse të operacioneve të forcave të tregut dhe ndërveprimi i forcave të ofertës dhe kërkesës

1. Në përcaktimin nëse një praktikë tregu e propozuar për t'u krijuar si PPT përputhet me kriterin e përcaktuar në pikën (b) të nenit 21 (2) të kësaj rregulloreje, Autoriteti merr në konsideratë nëse praktika e tregut kufizon mundësitë për pjesëmarrësit e tjerë të tregut për t'iu përgjigjur transaksioneve. Autoriteti do të marrë në konsideratë gjithashtu minimalisht kriteret e mëposhtme në lidhje me llojet e personave që do të kryejnë praktikën e tregut pasi të krijohen si PPT:
 - a. nëse ata janë persona të mbikëqyrur;
 - b. nëse ata janë anëtarë të një vendi tregtimi ku do të kryhet PPT-ja;
 - c. nëse ata mbajnë regjistra të urdhrave dhe transaksioneve në lidhje me praktikën e tregut të kryer në një mënyrë që lejon që ajo të dallohet lehtësisht nga aktivitetet e tjera tregtare, duke përfshirë mbajtjen e llogarive të veçanta për performancën e PPT-së, në veçanti për të demonstruar që urdhrat e regjistruar regjistrohen veçmas dhe individualisht pa grumbulluar urdhra nga klientë të ndryshëm;
 - ç. nëse ata kanë vënë në zbatim procedura të brendshme specifike që lejojnë:
 - (i) identifikimin e menjëhershëm të aktiviteteve që lidhen me praktikën e tregut;
 - (ii) disponueshmërinë e urdhrave përkatës dhe regjistrimeve të transaksioneve tek autoriteti kompetent sipas kërkesës;
 - d. nëse ata zotërojnë përputhshmërinë dhe burimet e auditimit të nevojshme për të monitoruar dhe siguruar pajtueshmërinë në çdo kohë me kushtet e përcaktuara për PPT-në;

- e. nëse i mbajnë regjistrimet e përmendura në pikën (c) të këtij paragrafi për një periudhë të paktën pesëvjeçare.
2. Autoriteti merr në konsideratë shkallën në të cilën praktika e tregut krijon një listë “*ex ante*” të kushteve të tregtimit për performancën e saj PPT, duke përfshirë kufijtë në lidhje me çmimet dhe vëllimet dhe kufizimet në pozicione.
3. Autoriteti vlerëson shkallën në të cilën praktika e tregut dhe marrëveshja ose kontrata për zbatimin e saj:
 - a. i mundëson personit që kryen PPT-në të veprojnë në mënyrë të pavarur nga përfituesi pa iu nënshtruar udhëzimeve, informacionit ose ndikimit nga përfituesi në lidhje me mënyrën në të cilën do të kryhet tregtimi;
 - b. lejon shmangien e konfliktit të interesit ndërmjet përfituesit dhe klientëve të personit që kryen PPT-në.

Neni 4 Ndikimi në likuiditetin dhe efikasitetin e tregut

Në përcaktimin nëse një praktikë tregu e propozuar për t’u krijuar si PPT përputhet me kriterin e përcaktuar në pikën (c) të nenit 21 (2) të kësaj rregulloreje, Autoriteti vlerëson ndikimin që ka praktika e tregut të paktën në elementët e mëposhtëm:

- a. vëllimin e tregtuar;
- b. numrin e urdhrave në librin e urdhrave (thellësia e urdhrave);
- c. shpejtësinë e ekzekutimit të transaksioneve;
- ç. çmimin mesatar të ponderuar të vëllimeve të një sesioni të vetëm, çmimin ditor të mbylljes;
- d. diferencën e çmimeve (bid-offer spread), luhatjet e çmimeve dhe paqëndrueshmërinë;
- e. rregullsinë e kuotimeve ose transaksioneve.

Neni 5 Ndikimi në funksionimin e duhur të tregut

1. Në përcaktimin nëse një praktikë tregu e propozuar për t’u krijuar si PPT përputhet me kriterin e përcaktuar në pikën (ç) të nenit 21 (2) të kësaj rregulloreje, Autoriteti merr parasysh elementët e mëposhtëm:
 - a. mundësinë që praktika e tregut mund të ndikojë në proceset e formimit të çmimeve në një vend tregtimi;
 - b. shkallën në të cilën praktika e tregut mund të lehtësojë vlerësimin e çmimeve dhe urdhrave të regjistruara në librin e urdhrave dhe nëse transaksionet që do të kryhen ose urdhrat që do të regjistrohen për performancën e tij si PPT nuk bien ndesh me rregullat e tregtimit të vendit përkatës të tregtimit;

- c. modalitetet me të cilat informacioni i referuar në nenin 2 të kësaj shtojce i bëhet me dije publikut, duke përfshirë publikimin e tij në faqen e internetit të platformës përkatëse të tregtimit dhe, kur është e përshtatshme, kur publikohet njëkohësisht në faqet e internetit të përfituesve;
- ç. shkallën në të cilën praktika e tregut krijon një listë *ex-ante* të situatave ose kushteve kur performanca e saj si PPT pezullohet ose kufizohet përkohësisht, ndër të tjera, periudha ose faza të veçanta tregtimi si fazat e ankandit, blerjet, ofertat publike fillestare, rritje kapitali, oferta dytësore.

Për qëllimet e pikës (b) të nënparagrafit të parë të këtij neni, do të merret në konsideratë edhe një praktikë tregu ku transaksionet dhe urdhrat monitorohen në kohë reale nga operatori i tregut ose shoqëria komisionere ose operatorët e tregut që operojnë një PSHT ose një POT.

2. Autoriteti do të vlerësojë shkallën në të cilën një praktikë tregu mundëson:

- a. urdhrat që lidhen me performancën e tij për t'u dorëzuar dhe ekzekutuar gjatë fazave të hapjes ose mbylljes së ankandit të një sesioni tregtar;
- b. urdhrat ose transaksionet që lidhen me performancën e tij që do të prezantohen ose kryhen gjatë periudhave kur kryhen operacionet e stabilizimit dhe riblerjes.

Neni 6

Risqet për integritetin e tregjeve të lidhura

Në përcaktimin nëse një praktikë tregu e propozuar për t'u krijuar si PPT përputhet me kriterin e përcaktuar në pikën (d) të nenit 21 (2) të kësaj rregulloreje, Autoriteti do të marrë në konsideratë:

- a. nëse transaksionet që lidhen me performancën e praktikës së tregut pasi të krijohen si PPT do t'u raportohen rregullisht autoriteteve kompetente;
- b. nëse burimet (kesh ose instrumentet financiare) që do të ndahen për performancën e PPT-së janë proporcionale dhe në përpjesëtim me objektivat e vetë PPT-së;
- c. natyrën dhe nivelin e kompensimit për shërbimet e ofruara në kuadër të performancës së një PPT-je dhe nëse ai kompensim përcaktohet si një shumë fikse; kur propozohet kompensimi i ndryshueshëm, ai nuk duhet të çojë në sjellje që mund të dëmtojnë integritetin e tregut ose funksionimin e rregullt të tregut dhe duhet të jenë në dispozicion të Autoritetit për vlerësim;
- ç. nëse lloji i personave që do të kryejnë PPT-në sigurojnë, kur është e përshtatshme për tregun në shqyrtim, një ndarje të duhur të aktiveve të dedikuara për performancën e PPT-së nga aktivet e klientëve të saj, nëse ka, ose aktivet e veta;
- d. nëse detyrat përkatëse të përfituesve dhe të personave që kryejnë PPT-në ose, janë të përcaktuara qartë;
- e. nëse lloji i personave që do të kryejnë PPT-në kanë në zbatim një strukturë organizative dhe marrëveshje të brendshme të duhura për të siguruar që vendimet e tregtimit në lidhje me PPT-në të mbeten konfidenciale nga njësitë e tjera brenda atij personi dhe të pavarura

nga urdhrat për tregtim të marra nga klientët, menaxhimi i portofolit ose urdhra të vendosura për llogari të tij;

- f. nëse ekziston një proces i duhur raportimi midis përfituesit dhe personit që do të kryejë PPT për të lejuar shkëmbimin e informacionit të nevojshëm për të përmbushur detyrimet e tyre përkatëse ligjore ose kontraktuale, nëse është e zbatueshme.

Neni 7 **Hetimi i praktikës së tregut**

Në përcaktimin nëse një praktikë tregu e propozuar për t'u krijuar si PPT përputhet me kriterin e përcaktuar në nenin 21 (2) të kësaj rregulloreje, Autoriteti do të marrë veçanërisht parasysh rezultatin e çdo hetimi në tregjet që ata monitorojnë që mund të vërë në pikëpyetje PPT-në që do të krijohet.

Neni 8 **Karakteristikat strukturore të tregut**

Duke marrë parasysh, në përputhje me nenin 21 (2) të kësaj rregulloreje, pjesëmarrjen e investitorëve joprofesionistë në tregun përkatës, Autoriteti do të vlerësojë minimalisht:

- a. ndikimin që praktika e tregut mund të ketë në interesat e investitorëve joprofesionistë ku praktika e tregut ka të bëjë me instrumentet financiare që tregtohen në tregjet ku marrin pjesë këta investitorë;
- b. nëse praktika e tregut rrit probabilitetin e investitorëve joprofesionistë për të gjetur një kundërpalë në instrumente financiare me likuiditet të ulët, pa rritur risqet që mbartin ata.

SEKSIONI 3 **Procedurat**

Neni 9 **Njoftimi kur synoni të krijoni një praktikë të pranuar në treg**

1. Në përputhje me nenin 21 (3) të kësaj rregulloreje, Autoriteti duhet të njoftojë njëkohësisht tek autoritetet e tjera kompetente jashtë Republikës së Shqipërisë me postë ose mëpërjet postës elektronike synimin për të krijuar një PPT. synimin për të krijuar një PPT .
2. Njoftimi i referuar në paragrafin 1 duhet të përfshijë elementët e mëposhtëm:
 - a. një deklaratë referuar synimit për të krijuar një PPT, duke përfshirë datën e pritshme të themelimit;
 - b. identifikimin e autoritetit kompetent njoftues dhe detajet e kontaktit të personit(ve) kontaktues brenda atij autoriteti kompetent (emri, numri i telefonit profesional dhe adresa e postës elektronike, titulli);
 - c. një përshkrim të detajuar të praktikës së tregut duke përfshirë:
 - (i) identifikimin e llojeve të instrumentit financiar dhe vendeve të tregtimit në të cilat do të kryhet PPT-ja;

- (ii) llojet e personave që mund të kryejnë PPT-në;
 - (iii) llojin e përfituesve;
 - (iv) tindikatorin nëse praktika e tregut mund të kryhet për një periudhë të caktuar kohore dhe për çdo situatë ose kusht që çon në një ndërprerje, pezullim ose përfundim të përkohshëm të praktikës;
- ç. arsyen për të cilën praktika mund të përbëjë manipulim tregu sipas nenit 20 të kësaj rregulloreje;
- d. detajet e vlerësimit të bërë sipas nenit 21 (2) të kësaj rregulloreje
3. Njoftimi i referuar në paragrafin (1) të këtij neni përfshin tabelën për vlerësimin e një praktike të propozuar të tregut duke përdorur modelin në Tabelën 1.

SEKSIONI 4

Mirëmbajtja, modifikimi dhe përfundimi i praktikave të pranuarra të tregut

Neni 10

Rishikimi i një PPT-je të krijuar

1. Autoriteti vlerëson rregullisht, dhe të paktën çdo dy vjet, nëse kushtet për krijimin e PPT-ve të përcaktuara në nenin 21 (2) të kësaj rregulloreje dhe në Seksionin 2 të këtij kreu, vazhdojnë të plotësohen.
2. Pavarësisht nga rishikimi i rregullt në përputhje me nenin 21 të kësaj rregulloreje, procesi i vlerësimit i referuar në paragrafin (1) do të fillojë gjithashtu:
 - a. kur është vendosur çfarëdo sanksioni që përfshin një PPT të krijuar;
 - b. kur për shkak të një ndryshimi të rëndësishëm në mjedisin e tregut të përmendur në nenin 22 të kësaj rregulloreje, një ose më shumë nga kushtet e pranimit të një praktike të vendosur nuk plotësohen më;
 - c. kur Autoriteti ka arsye të dyshojë se akte në kundërshtim me këtë po kryhen ose janë kryer nga përfitues të PPT-së, ose nga persona që e realizojnë atë.
3. Në rast se vlerësimi zbulon se një PPT e krijuar nuk i plotëson më kushtet e vlerësimit fillestar të Autoritetit të përcaktuara në Seksionin 2, Autoriteti ose do të propozojë modifikimin e kushteve të pranimit ose do t'i japë fund PPT-së, duke marrë parasysh kriteret e përcaktuara në nenin 21.
4. Kur Autoriteti propozon modifikimin e kushteve të pranimit të një PPT-je të krijuar, ai duhet të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 1 të kësaj Shtojce.
5. Kur Autoriteti vendos t'i japë fund një PPT-je të krijuar, ai do të bëjë me dije publikisht dhe do t'ua komunikojë vendimin e tij njëkohësisht të gjitha autoriteteve të tjera kompetente në BE, duke treguar datën e përfundimit.

Neni 11
Kriteret për modifikimin ose përfundimin e një PPT-je

Në përcaktimin nëse do t'i japë fund një PPT të krijuar ose do të propozojë modifikimin e kushteve të pranimit të saj, Autoriteti duhet të ketë parasysh:

- a. masën në të cilën përfituesit ose personat që kryejnë PPT kanë përmbushur kushtet e përcaktuara në atë PPT;
- b. masën në të cilën sjellja e përfituesve ose e personave që kryejnë një PPT ka rezultuar që ndonjë nga kriteret e përcaktuara në nenin 21 (2) të kësaj rregulloreje të mos përmbushet më;
- c. masën në të cilën PPT nuk është përdorur nga pjesëmarrësit e tregut për një periudhë kohore;
- ç. nëse një ndryshim i rëndësishëm në mjedisin përkatës të tregut të përmendur në nenin 21 të kësaj rregulloreje rezulton që ndonjë prej kushteve për krijimin e PPT-së të mos jetë më i mundur ose të mos jetë i nevojshëm për t'u përmbushur, duke marrë parasysh në veçanti:
 - (i) nëse objektivi i PPT-së është bërë i përealizueshëm,
 - (ii) nëse përdorimi i vazhdueshëm i PPT-së së krijuar mund të ndikojë negativisht në integritetin ose efikasitetin e tregjeve nën mbikëqyrjen e Autoritetit;
- d. nëse ekziston një situatë që bie brenda ndonjë dispozite të përgjithshme për përfundimin e praktikës e përfshirë në vetë PPT-në e krijuar.

Tabela: Modeli për njoftimin e synimit për të krijuar praktika të pranuar në treg

| |
|--|
| Praktika e pranuar e tregut (PPT) mbi [shënoni emrin e PPT-së] |
| Data e propozuar e themelimit të PPT-së: [shënoni datën në të cilën PPT-ja synohet të krijohet nga autoriteti kompetent njoftues] |
| <p>Përshkrimi i PPT-së:</p> <p>[shënoni në tekst, duke përfshirë identifikimin e llojeve të instrumentit financiar dhe vendeve të tregtimit në të cilat do të kryhet PPT-ja; llojet e personave që mund të kryejnë PPT-në, llojin e përfituesve dhe, treguesin nëse praktika e tregut mund të kryhet për një periudhë të caktuar kohore dhe çdo situatë ose kusht që çon në një ndërprerje, pezullim ose përfundim të përkohshëm të praktikës]</p> |
| Arsyetimi për të cilin praktika mund të përbëjë manipulim tregu [shënoni tekst] |

| VLERËSIMI | |
|--|--|
| Lista e kritereve të marra parasysh | Konkluzioni i autoritetit kompetent dhe arsyetimi |
| (a) Niveli i transparencës që i ofrohet tregut | [vendosni një tekst për të plotësuar arsyetimin për këtë kriter] |
| (b) Shkalla e masave mbrojtëse për funksionimin e forcave të tregut dhe ndërveprimin e duhur të forcave të ofertës dhe kërkesës. | [vendosni një tekst për të plotësuar arsyetimin për këtë kriter] |
| (c) Ndikimi në likuiditetin dhe efikasitetin e tregut. | [vendosni një tekst për të plotësuar arsyetimin për këtë kriter] |
| (d) Mekanizmi i tregtimit të tregut përkatës dhe mundësia që pjesëmarrësit e tregut të reagojnë siç duhet dhe në kohën e duhur ndaj situatës së re të tregut të krijuar nga kjo praktikë. | [vendosni një tekst për të plotësuar arsyetimin për këtë kriter] |
| (e) Rreziqet për integritetin, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, të tregjeve të ndërlidhura, qofshin të rregulluara ose jo, në instrumentet financiare përkatëse. | [vendosni një tekst për të plotësuar arsyetimin për këtë kriter] |
| (f) Rezultati i çdo hetimi të praktikës përkatëse të tregut nga çdo autoritet kompetent ose autoritet tjetër, veçanërisht nëse praktika përkatëse e tregut ka shkelur rregullat ose rregulloret e krijuara për të parandaluar abuzimin e tregut ose kodet e sjelljes, pavarësisht nëse ka të bëjë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, me tregun përkatës ose tregjet përkatëse. | [vendosni një tekst për të plotësuar arsyetimin për këtë kriter] |
| (g) Karakteristikat strukturore të tregut përkatës, ndër të tjera, nëse ai është i rregulluar apo jo, llojet e instrumenteve financiare të tregtuara dhe lloji i pjesëmarrësve në treg, duke përfshirë masën e pjesëmarrjes së investitorëve joprofesionistë në tregun përkatës. | [vendosni një tekst për të plotësuar arsyetimin për këtë kriter] |

**SHTOJCA IV – Raportet e Transaksioneve dhe Urdhrave të Dyshimtë (STOR) -Model
[Identiteti dhe detajet e kontaktit të personit që është subjekt i detyrimit për njoftim]**

SEKSIONI 1

Hyrje

DEKLARATA E NJOFTUESIT

Me siguri të plotë, deklarojmë se të gjitha informacionet dhe të dhënat që përfshihen në këtë Deklaratë janë të sakta dhe korrekte dhe se asnjë informacion ose e dhënë që ndikon në saktësinë dhe plotësinë e informacionit nuk është hequr,

nënshkruar nga [përfaqësuesi i autorizuar i njoftuesit]

PËRGJEGJËSIA PËR INFORMACIONIN QË PËRMBAN DEKLARATA

Njoftuesi pranon përgjegjësinë për informacionin dhe të dhënat e përfshira në këtë deklaratë. Informacioni është në përputhje me faktet dhe nuk lë jashtë asnjë informacion që do të cenonte rëndësinë e tij. Kur përdoren të dhëna nga burimet e palëve të treta, informacioni në fjalë riprodhohet saktësisht dhe emetuesi është në gjendje të sqarojë informacionin e publikuar nga kjo palë e tretë dhe se nuk është lënë jashtë asnjë fakt që do ta bënte të pasaktë apo keqorientues informacionin e riprodhuar. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nuk e ka verifikuar saktësinë dhe korrektësinë e informacioneve që përmban kjo deklaratë.

SEKSIONI 1

IDENTITETI I SUBJEKTIT/PERSONIT QË DORËZON STOR-IN

Personat që rregullojnë ose ekzekutojnë në mënyrë profesionale transaksione/Operatorët e tregut dhe shoqëritë komisionere që vënë në funksion një vend tregtimi — Specifikoni në çdo rast:

| | |
|--------|--|
| Zëri 1 | Emrin e personit fizik [Emri(at) dhe mbiemrin(at) e personit fizik përgjegjës për dorëzimin e STOR-it] |
| Zëri 2 | Pozicioni brenda entit apo shoqërisë raportuese [Pozicioni i personit fizik përgjegjës për dorëzimin e STOR-it brenda subjektit dorëzues.] |
| Zëri 3 | Emri i entit apo shoqërisë raportuese. [Emri i plotë i entit apo shoqërisë raportuese, duke përfshirë personat juridikë: – formën ligjore siç parashikohet në regjistrin e vendit në përputhje me ligjin në të cilin është përfshirë, kur është e zbatueshme, dhe – kodin e identifikuesit të subjektit juridik (NIPT)] |
| Zëri 4 | Adresa e subjektit raportues [Adresa e plotë (p.sh. rruga, numri i rrugës, kodi postar, qyteti, shteti/provinca)] |

| | |
|--------|---|
| Zëri 5 | <p>ftësia vepruese e subjektit në lidhje me urdhrat ose transaksionet që mund të përbëjnë tregtim ose tentativë tregtimi bazuar në informacion të privilegjuar, manipulim tregu.</p> <p>[Përshkrimi i kapacitetit në të cilin subjekti raportues po vepron në lidhje me urdhrin(at) ose transaksionin(et) që mund të përbënin tregtim bazuar në informacion të privilegjuar, manipulim tregu ose tentativë për tregtim bazuar në informacion të privilegjuar ose manipulime të tregut, p.sh. ekzekutimi i urdhrave në emër të klientëve, transaksionet për llogari të tyre, vënia në funksion e një vendi tregtimi, internalizuesi sistematik].</p> |
| Zëri 6 | Lloji i aktivitetit tregtar (krijim tregu, arbitrazh etj.) dhe lloji i instrumentit të tregtuar (tituj, derivativë, etj.) nga subjekti. |
| Zëri 7 | <p>Marrëdhëniet me personin në lidhje me të cilin është dorëzuar STOR</p> <p>[Përshkrimi i çdo marrëveshjeje korporate, kontraktuale ose organizative ose rrethanash ose marrëdhëniesh]</p> |
| Zëri 8 | <p>Kontaktin për kërkesë shtesë për informacion</p> <p>[Personi që do të kontaktohet brenda subjektit raportues për kërkesë shtesë për informacion në lidhje me këtë raport (p.sh. zyrtari i përputhshmërisë) dhe detajet përkatëse të kontaktit:</p> <ul style="list-style-type: none"> – emri(at) dhe mbiemri(at), – pozicioni i personit kontaktues brenda subjektit raportues, – Adresa e postës elektronike profesionale.] |

SEKSIONI 2 TRANSAKSIONI/URDHRI

| | |
|--------|---|
| Zëri 1 | <p>Përshkrimi i instrumentit financiar:</p> <p>[Përshkruani instrumentin financiar që është objekt i STOR-it, duke specifikuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> – emrin e plotë ose përshkrimin e instrumentit financiar, – kodin identifikues të instrumentit, kur është e zbatueshme, – llojin e instrumentit financiar sipas taksonomisë së përdorur për të klasifikuar instrumentin financiar dhe kodin shoqërues.] <p>[Elementë shtesë për urdhrat dhe transaksionet në lidhje me derivatet OTC (Lista e të dhënave më poshtë nuk është shteruese)</p> <ul style="list-style-type: none"> – Identifikoni llojin e derivatit OTC (p.sh. kontratat për diferencën (CFD), marrëveshjet e shkëmbimit (sëaps), kontratat e shkëmbimit për rrezikun e kreditit (<i>Credit Default Sëaps</i> (CDS)) dhe opsionet e tregut mbi banak (<i>Over-The-Counter</i> (OTC)). – Përshkruani karakteristikat e derivatit OTC, duke përfshirë të paktën, kur është e përshtatshme për llojin e veçantë të derivatit, sa vijon: <ul style="list-style-type: none"> • shumën nominale (vlerën nominale), • monedhën e denominimit/emetimit, |
|--------|---|

| | |
|--------|---|
| | <ul style="list-style-type: none"> • datën e maturimit, • çmimin, • normën e interesit. <p>– Përshkruani të paktën sa vijon, kur është e përshtatshme për llojin e veçantë të derivatit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Marzhi, pagesa paraprake dhe madhësia ose vlera nominale e instrumentit financiar bazë, • Kushtet e transaksionit të tilla si çmimi <i>strike</i>, kushtet e kontratës (p.sh. fitimi ose humbja për çdo levizje PIP nga spekulimi). <p>– Përshkruani instrumentin financiar bazë të derivatit OTC duke specifikuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Emrin e plotë të instrumentit financiar bazë ose përshkrimin e instrumentit financiar, • Kodin identifikues të instrumentit, kur është i disponueshëm, • Llojin e instrumentit financiar sipas taksonomisë së përdorur për të klasifikuar instrumentin financiar dhe kodin shoqërues |
| Zëri 2 | <p>Data dhe ora e transaksioneve ose urdhrave që mund të përbëjnë tregtim bazuar në informacion të privilegjuar, manipulim tregu ose tentativë për tregtim bazuar në informacion të privilegjuar ose manipulim tregu</p> <p>[Tregoni datën(at) dhe orën(et) e urdhrit(ve) ose transaksionit(ve).]</p> |
| Zëri 3 | <p>Tregu ku ka ndodhur urdhri ose transaksioni</p> <p>[Specifikoni:</p> <ul style="list-style-type: none"> – emrin dhe kodin për të identifikuar vendin e tregtimit, internalizuesin sistematik ose platformën e organizuar të tregtimit ku është dhënë urdhri dhe është ekzekutuar transaksioni, ose – nëse urdhri nuk është dhënë ose transaksioni nuk është ekzekutuar në ndonjë nga vendet e sipërpërmendura, ju lutemi përmendni “jashtë një vendi tregtimi”.] |
| Zëri 4 | <p>Vendndodhja (shteti)</p> <p>[Emri i plotë i shtetit] [Specifikoni:</p> <ul style="list-style-type: none"> – ku jepet urdhri (nëse është e disponueshme), – ku ekzekutohet urdhri.] |
| Zëri 5 | <p>Përshkrimi i urdhrit ose transaksionit</p> <p>[Përshkruani të paktën karakteristikat e mëposhtme të urdhrave ose transaksioneve të raportuara</p> <ul style="list-style-type: none"> – numrin/urdrin e referencës së transaksionit; numrin e referencës (aty ku është i disponueshëm), – datën dhe orën e shlyerjes, – çmimin e blerjes/çmimin e shitjes, – vëllimin/sasinë e instrumenteve financiare, |

| | |
|--|--|
| | <p>[Kur ka urdhra ose transaksione të shumta që mund të përbëjnë tregtim bazuar në informacion të privilegjuar, manipulim tregu ose përpjekje për tregtim bazuar në informacion të privilegjuar ose manipulime tregu, detajet mbi çmimet dhe vëllimet e urdhrave dhe transaksioneve të tilla mund t'i jepen autoritetit kompetent në një Shtojcë të STOR-it.]</p> <ul style="list-style-type: none"> - informacion mbi dorëzimin e urdhrit, duke përfshirë të paktën sa vijon: <ul style="list-style-type: none"> • llojin e urdhrit, përfshirë dhe urdhrat me kufi , • mënyra se si është dhënë urdhri (p.sh. libri elektronik i urdhrave , • kohën kur është dhënë urdhri, • personin që ka dhënë urdhrin, • personin që ka marrë urdhrin, • mjetet me të cilat transmetohet urdhri. - Informacione mbi anulimin ose ndryshimin e urdhrit (aty ku është e disponueshme): <ul style="list-style-type: none"> • kohën e ndryshimit ose anulimit, • personin që ka ndryshuar ose anuluar urdhrin, • natyrën e ndryshimit (p.sh. ndryshimi në çmim ose sasi) dhe masën e ndryshimit, <p>[Kur ka urdhra ose transaksione të shumta që mund të përbëjnë tregtim bazuar në informacion të privilegjuar, manipulim tregu ose përpjekje tregtim bazuar në informacion të privilegjuar ose manipulime tregu, detaje mbi çmimet dhe vëllime të urdhrave dhe transaksioneve të tilla mund t'i jepen autoritetit kompetent në një Shtojcë të STOR-it.]</p> <ul style="list-style-type: none"> • mjetet për të ndryshuar urdhrin (p.sh. nëpërmjet postës elektronike, telefonit, etj.).] |
|--|--|

SEKSIONI 3 PËRSHKRIMI I NATYRËS SË RASTEVE TË DYSHIMTA

| | |
|---------------|---|
| <p>Zëri 1</p> | <p>Natyra e rasteve të dyshimta</p> <p>[Specifikoni llojin e shkeljes që mund të përbëjnë urdhrat ose transaksionet e raportuara:</p> <ul style="list-style-type: none"> - manipulim tregu, - tregtim bazuar në informacion të privilegjuar, - tentativë për të kryer manipulim tregu, - tentativë për të tregtuar bazuar në informacion të privilegjuar.] |
| <p>Zëri 2</p> | <p>Arsyet e rasteve të dyshimta</p> <p>[Përshkrimi i aktivitetit (transaksionet dhe urdhrat, mënyra e vendosjes së urdhrave ose e ekzekutimit të transaksionit dhe karakteristikat e urdhrave dhe transaksioneve që i bëjnë ato të dyshimta); të paraqitet mënyra si i çështja ra në vëmendjen e personit raportues dhe të specifikohen arsyet e këtij dyshimi. Përshkrimi mund të përfshijë si kritere udhëzuese jo shteruese:</p> |

| | |
|--|---|
| | <ul style="list-style-type: none"> - për instrumentet financiare të pranuar për tregtim në/tregtuar në një vend tregtimi, një përshkrim të natyrës së ndërveprimit/transaksioneve të librit të urdhrave që mund të përbëjnë tregtim bazuar në informacion të privilegjuar, manipulim tregu ose tentativë për të tregtuar bazuar në informacion të privilegjuar ose për të bërë manipulim tregu, - për derivativët OTC, detaje në lidhje me transaksionet ose urdhrat e vendosur në asetin bazë dhe informacion mbi çdo lidhje të mundshme midis transaksioneve në tregun e parasë të aktivitetit bazë dhe transaksioneve të raportuara në derivativin OTC.] |
|--|---|

SEKSIONI 4

IDENTITETI I PERSONIT, URDRAT APO TRANSAKSIONET E TË CILIT MUND TË PËRBËJNË RAST TREGTIMI BAZUAR NË INFORMACION TË PRIVILEGJUAR, MANIPULIM TREGU OSE TENTATIVË PËR TË TREGTUAR BAZUAR NË INFORMACION TË PRIVILEGJUAR OSE PËR TË KRYER MANIPULIM TREGU (“PERSON I DYSHUAR”)

| | |
|---------------|--|
| Zëri 1 | <p>Emri</p> <p>[Për personat fizikë: Emri(at) dhe mbiemrin(at).]</p> <p>Për personat juridikë: emri i plotë duke përfshirë formën ligjore siç parashikohet në regjistrin e vendit në përputhje me ligjet e të cilit është themeluar, nëse është e zbatueshme, si dhe Nipti i Subjektit Juridik, aty ku është e zbatueshme.]</p> |
| Zëri 2 | <p>Data e lindjes</p> <p>[Vetëm për personat fizikë]</p> <p>[vvvv-mm-dd]</p> |
| Zëri 3 | <p>NIPT</p> |
| Zëri 4 | <p>Adresa</p> <p>[Adresa e plotë (p.sh. rruga, numri i rrugës, kodi postar, qyteti/provinca, shteti).]</p> |
| Zëri 5 | <p>Informacion për punësimin:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vendi - Pozicioni <p>[Informacion në lidhje me punësimin e personit të dyshuar, nga burimet e brendshme të informacionit të disponueshme për subjektin raportues (p.sh. dokumentacioni i llogarisë në rastin e klientëve, sistemi i informacionit të stafit në rastin e një punonjësi të subjektit raportues).]</p> |
| Zëri 6 | <p>Numri(at) e llogarisë</p> <p>[Numrat e llogarive në cash dhe në tituj, çdo llogarie të përbashkët ose çdo autorizim për llogarinë që mban subjekti/personi i dyshuar]</p> |
| Zëri 7 | <p>Identifikuesi i klientit sipas raportimit të transaksionit</p> |

| | |
|---------------|---|
| Zëri 8 | <p>Marrëdhëniet me emetuesin e instrumenteve financiare në fjalë (aty ku është e zbatueshme dhe aty ku është e ditur)</p> <p>[Përshkrimi i çdo mase/procedure të shoqërisë, kontraktuale ose organizative ose rrethanash ose marrëdhëniesh]</p> |
|---------------|---|

SEKSIONI 5 INFORMACIONE SHITESË

Historiku ose çdo informacion tjetër që subjekti raportues duhet të marrë në konsideratë në hartimin e raportit

| |
|---|
| <p>[Lista e mëposhtme nuk është shteruese.</p> <ul style="list-style-type: none"> – Kategorizimi i personit të dyshuar (p.sh. klient joprofesionistë, institucion), – Natyra e ndërhyrjes së subjektit/personit të dyshuar (për llogari të vet, në emër të klientit, të tjerëve), – Madhësia e portofolit të subjektit/personit të dyshuar, – Data në të cilën filloi marrëdhënia e biznesit me klientin nëse subjekti/personi i dyshuar është klient i personit/subjektit raportues, – Lloji i aktivitetit të njësisë që merret me tregtim të subjektit të dyshuar, nëse ka. – Modelet e tregtimit të subjektit/personit të dyshuar. Për udhëzim, më poshtë paraqiten shembuj të informacioneve që mund të jenë të dobishme: <ul style="list-style-type: none"> • natyra tregtare e subjektit/personit të dyshuar për sa i përket përdorimit të levës financiare (leverage) dhe • krahasueshmëria e madhësisë së urdhrave/transaksionit të raportuar me madhësinë mesatare të urdhrave të dorëzuara/transaksioneve të kryera nga subjekti/personi i dyshuar në 12 muajt e fundit, • natyra e subjektit/personit të dyshuar në lidhje me emetuesit, titujt ose llojet e instrumenteve financiare që ka tregtuar në 12 muajt e fundit, veçanërisht nëse urdhri/transaksioni i raportuar lidhet me një emetues, titujt të të cilit janë tregtuar nga subjekti/personi i dyshuar vitin e kaluar. – Subjekte/persona të tjerë që dihet se janë të përfshirë në urdhra ose transaksione, të cilat mund të përbëjnë tregtim bazuar në informacion të privilegjuar, manipulim tregu ose tentativë për të tregtuar bazuar në informacion të privilegjuar ose për të bërë manipulim tregu: <ul style="list-style-type: none"> • Emrat, • Aktiviteti (p.sh. ekzekutimi i urdhrave në emër të klientëve, tregtim për llogari të vet, vënia në funksion e një vendi tregtimi, internalizuesi sistematik, etj.)] |
|---|

SEKSIONI 6 DOKUMENTACIONI BASHKËLIDHUR

| |
|---|
| <p>[Rendisni të gjitha materialet mbështetëse bashkëlidhur.</p> <p>Shembuj të këtij dokumentacioni janë posta elektronike, regjistrimet e bisedave, regjistrimet e urdhrave/transaksioneve, konfirmimeve, raportet e brokerave, dhe komentet e medias aty ku është e nevojshme.</p> <p>Kur informacioni i detajuar rreth urdhrave/transaksioneve të referuara në SEKSIONIN 2 të këtij modeli jepet në një shtojcë të veçantë, tregoni titullin e asaj Shtojcë.]</p> |
|---|

**SHTOJCA V – FORMULARI STANDARD PËR NJOFTIMIN E INFORMACIONIT
TË PRIVILEGJUAR**
**[Identiteti dhe detajet e kontaktit të emetuesit, duke përfshirë identifikuesin e personit
juridik të tij (NIPT)]**

SEKSIONI 1

Hyrje

DEKLARATA E EMETUESIT

Me siguri të plotë, deklarojmë se të gjitha informacionet dhe të dhënat që përfshihen në këtë Deklaratë janë të sakta dhe korrekte dhe se asnjë informacion ose e dhënë që ndikon në saktësinë dhe plotësinë e informacionit nuk është hequr.

nënshkruar nga [përfaqësuesi i autorizuar i emetuesit]

PËRGJEGJËSIA PËR INFORMACIONIN QË PËRMBAN DEKLARATA

Emetuesi pranon përgjegjësinë për informacionin dhe të dhënat e përfshira në këtë deklaratë. Informacioni është në përputhje me faktet dhe nuk lë jashtë asnjë informacion që do të cenonte rëndësinë e tij. Kur përdoren të dhëna nga burimet e palëve të treta, informacioni në fjalë riprodhohet saktësisht dhe emetuesi është në gjendje të sqarojë informacionin e publikuar nga kjo palë e tretë dhe se nuk është lënë jashtë asnjë fakt që do ta bënte të pasaktë apo keqorientues informacionin e riprodhuar. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nuk e ka verifikuar saktësinë dhe korrektësinë e informacioneve që përmban kjo deklaratë.

SEKSIONI 2

Informacione kryesore për emetuesin

| | |
|------------------|--|
| Zëri 1 | Të dhënat e emetuesit |
| Zëri 1.1. | Vendbanimi dhe statusi juridik i emetuesit |
| Zëri 1.2. | 2Identifikuesi i subjektit juridik (NIPT) |
| Zëri 1.3. | Ligji sipas të cilit operon Emetuesi |
| Zëri 1.4. | Vendi i themelimit të Emetuesit |

SEKSIONI 2

Informacionet kryesore për personin që bën njoftimin

| | |
|---------------|---------------------------------------|
| Zëri 1 | Të dhënat e personit që bën njoftimin |
|---------------|---------------------------------------|

| | |
|------------------|---|
| Zëri 1.1. | Emri, Mbiemri |
| Zëri 1.2. | Pozicioni që mbannë lidhje me emetuesit |

SEKSIONI 3
Informacione të privileguara

| | |
|------------------|--|
| Zëri 1 | Informacione të privilegjuar |
| Zëri 1.1. | Fusha referuar informacionit të privilegjuar |
| Zëri 1.2. | Shpjegimi i informacionit të privilegjuar |
| Zëri 1.3. | Data dhe ora e komunikimit me mediat |

**SHTOJCA VI – FORMULARI STANDARD PËR NJOFTIMIN E DHËNIES ME
VONESË TË INFORMACIONIT TË PRIVILEGJUAR OSE QËLLIMIT PËR TË
VONUAR DHËNIEN E INFORMACIONIT TË PRIVILEGJUAR**
[Identiteti dhe detajet e kontaktit të emetuesit, duke përfshirë identifikuesin e personit
juridik (NIPT)]

SEKSIONI 1
Hyrje

DEKLARATA E EMETUESIT

Me siguri të plotë, deklarojmë se të gjitha informacionet dhe të dhënat që përfshihen në këtë deklaratë janë të sakta dhe korrekte dhe se asnjë informacion ose e dhënë që ndikon në saktësinë dhe plotësinë e informacionit nuk është hequr.

nënshkruar nga [përfaqësuesi i autorizuar i emetuesit]

PËRGJEGJËSIA PËR INFORMACIONIN QË PËRMBAN DEKLARATA

Emetuesi pranon përgjegjësinë për informacionin dhe të dhënat e përfshira në këtë deklaratë. Informacioni është në përputhje me faktet dhe nuk lë jashtë asnjë informacion që do të cenonte rëndësinë e tij. Kur përdoren të dhëna nga burimet e palëve të treta, informacioni në fjalë riprodhohet saktësisht dhe emetuesi është në gjendje të sqarojë informacionin e publikuar nga kjo palë e tretë dhe se nuk është lënë jashtë asnjë fakt që do ta bënte të pasaktë apo keqorientuese informacionin e riprodhuar. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nuk e ka verifikuar saktësinë dhe korrektësinë e informacioneve që përmban kjo deklaratë.

SEKSIONI 2
Informacione kryesore për Emetuesin

| | |
|------------------|---|
| Zëri 1 | Të dhënat e emetuesit |
| Zëri 1.1. | Vendbanimi dhe statusi ligjor i Emetuesit |
| Zëri 1.2. | Identifikuesi i subjektit juridik (NIPT) |
| Zëri 1.3. | Ligji sipas të cilit vepron Emetuesi |
| Zëri 1.4. | Vendi i themelimit të Emetuesit |

SEKSIONI 2
Informacione kryesore për personin që bën njoftimin

| | |
|------------------|--|
| Zëri 1 | Të dhënat e personit që bën njoftimin |
| Zëri 1.1. | Emri, Mbiemri |
| Zëri 1.2. | Pozicioni që mban në lidhje me emetuesin |

| | |
|------------------|--|
| Zëri 1.3. | Të dhënat e kontaktit të personit që bën njoftimin: adresa e email-it profesional dhe numri i telefonit; |
|------------------|--|

SEKSIONI 3

Informacion i privilegjuar

| | |
|------------------|--|
| Zëri 1 | Informacion i privilegjuar |
| Zëri 1.1. | Fusha e referuar e informacionit të privilegjuar |
| Zëri 1.2. | Shpjegimi i informacionit të privilegjuar |

SEKSIONI 4

Vonesa e publikimit të Informacionit të Privilegjuar

| | |
|------------------|---|
| Zëri 1 | Baza e parë e informacionit të privilegjuar brenda emetuesit |
| Zëri 1.1. | Data e vendimit për shtyrjen e bërjes së njohur së informacionit të privilegjuar |
| Zëri 1.2. | Identiteti i të gjithë personave përgjegjës për vendimin për shtyrjen e publikimit të informacionit të privilegjuar |
| Zëri 1.3. | Koha kur emetuesi mund të bëjë të ditur informacionin e privilegjuar |

SEKSIONI 5

Plotësimi i kërkesave të kushteve në zbatim të Nenit 18, pika (3) të Rregullores për Kriteret e Transparencës të shoqërive të listuara

| | |
|---------------|---|
| Zëri 1 | Pse informacioni i privilegjuar sjell rrezikun e cenimit të stabilitetit financiar të emetuesit dhe të sistemit financiar |
| Zëri 2 | Pse vonesa e bërjes së njohur së informacioneve të privilegjuara është në interes të publikut |
| Zëri 3 | Si mund të sigurohet konfidencialiteti i informacionit të privilegjuar. |

SHTOJCA VII – FORMULARI STANDARD PËR LISTAT E PERSONAVE ME INFORMACION TË PRIVILEGJUAR

[Identiteti dhe detajet e kontaktit të emetuesit, duke përfshirë identifikuesin e personit juridik të tij (NIPT)]

SEKSIONI 1

Hyrje

DEKLARATA E EMETUESIT

Me siguri të plotë deklarojmë se të gjitha informacionet dhe të dhënat që përfshihen në këtë Deklaratë janë të sakta dhe korrekte dhe se asnjë informacion ose e dhënë që ndikon në saktësinë dhe plotësinë e informacionit nuk është hequr.

nënshkruar nga [përfaqësuesi i autorizuar i emetuesit]

PËRGJEGJËSIA PËR INFORMACIONIN QË PËRMBAN DEKLARATA

Emetuesi pranon përgjegjësinë për informacionin dhe të dhënat e përfshira në këtë deklaratë. Informacioni është në përputhje me faktet dhe nuk lë jashtë asnjë informacion që do të cenonte rëndësinë e tij. Kur përdoren të dhëna nga burimet e palëve të treta, informacioni në fjalë riprodhohet saktësisht dhe emetuesi është në gjendje të sqarojë informacionin e publikuar nga kjo palë e tretë dhe se nuk është lënë jashtë asnjë fakt që do ta bënte të pasaktë apo keqorientuese informacionin e riprodhuar. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nuk e ka verifikuar saktësinë dhe korrektësinë e informacioneve që përmban kjo deklaratë.

SEKSIONI 2

Informacione kryesore për emetuesin

| | |
|------------------|--|
| Zëri 1 | Të dhënat e emetuesit |
| Zëri 1.1. | Vendbanimi dhe statusi juridik i emetuesit |

SEKSIONI 3

Informacione kryesore për personin që bën njoftimin

| | |
|------------------|---|
| Zëri 1 | Të dhënat e personit që bën njoftimin |
| Zëri 1.1. | Emri, Mbiemri |
| Zëri 1.2. | Pozicioni që mban në lidhje me emetuesin |
| Zëri 1.3. | Të dhënat e kontaktit të personit që bën njoftimin: adresa e postës elektronike profesionale dhe numri i telefonit; |

SEKSIONI 4

Lista e personave me informacion të privilegjuar

| | | | | | | |
|---------------|---|--|---|--|--|--|
| Zëri 1 | Data në të cilën është hartuar lista e personave me informacion të privilegjuar | | | | | |
| Zëri 2 | Informacione kryesore për personat me informacion të privilegjuar | | | | | |
| | Nr. | Identiteti i personit me informacion të privilegjuar | Arsyeja për përfshirjen e personave me informacion të privilegjuar në listën e personave me informacion të privilegjuar | Data dhe ora në të cilën personi me informacion të privilegjuarka fituar akses në informacionet e privileguara | Data e përfshirjes së personit me informacion të privilegjuar në listën e personave me informacion të privilegjuar | Data dhe arsyeja për çdo ndryshim në informacionin për personin me informacion të privilegjuar |

**SHTOJCA VIII – FORMULARI STANDARD PËR TRANSAKSIONET E
DREJTUESVE**
[Identiteti dhe detajet e kontaktit të personit që është subjekt i detyrimit për njoftim]

SEKSIONI 1
Hyrje

DEKLARATA E NJOFTUESIT

Me siguri të plotë, deklarojmë se të gjitha informacionet dhe të dhënat që përfshihen në këtë Deklaratë të Përkohshme Menaxhimi janë të sakta dhe korrekte dhe se asnjë informacion ose e dhënë që ndikon në saktësinë dhe plotësinë e informacionit nuk është hequr.

nënshkruar nga [përfaqësuesi i autorizuar i njoftuesit]

PËRGJEGJËSIA PËR INFORMACIONIN QË PËRMBAN DEKLARATA

Njoftuesi pranon përgjegjësinë për informacionin dhe të dhënat e përfshira në këtë deklaratë. Informacioni është në përputhje me faktet dhe nuk lë jashtë asnjë informacion që do të cenonte rëndësinë e tij. Kur përdoren të dhëna nga burimet e palëve të treta, informacioni në fjalë riprodhohet saktësisht dhe emetuesi është në gjendje të sqarojë informacionin e publikuar nga kjo palë e tretë dhe se nuk është lënë jashtë asnjë fakt që do ta bënte të pasaktë apo keqorientues informacionin e riprodhuar. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nuk e ka verifikuar saktësinë dhe korrektësinë e informacioneve që përmban kjo deklaratë.

SEKSIONI 2

Informacione kryesore për personin me përgjegjësi menaxheriale/personin me lidhje të ngushta

| | | |
|---------------|-------------------------------|--|
| Zëri 1 | Personi fizik (emri, mbiemri) | Personi juridik |
| Zëri 2 | Data e lindjes | Qyteti i zyrës së regjistrimit, shteti |

SEKSIONI 3

Arsyeja për njoftim

| | |
|------------------|---|
| Zëri 1 | Pozicioni/statusi |
| Zëri 1.1. | Për personat që përmbushin përgjegjësi menaxheriale: duhet të tregohet pozicioni që mbanbrenda emetuesit, pjesëmarrësi i tregut kuotave të lejuara për çlirimin e gazeve serrë /platforma e ankandit/drejtuesi i ankandit/ monitoruesi i ankandit, p.sh. CEO (Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv), CFO (Drejtor i Financës) |
| Zëri 1.2. | Për personat me lidhje të ngushta, <ul style="list-style-type: none">• një tregues se njoftimi ka të bëjë me një person me lidhje të ngushta me një person që përmbush përgjegjësitë menaxheriale;• emri dhe pozicioni i personit përkatës që përmbush përgjegjësitë menaxheriale. |

| | |
|------------------|--|
| Zëri 2 | Njoftimi fillestar/Amendamenti |
| Zëri 2.1. | Indikacioni se ky është një njoftim fillestar ose një ndryshim në njoftimet e mëparshme. Në rast ndryshimi, shpjegoni gabimin që po ndryshon ky njoftim. |

SEKSIONI 4

Informacione kryesore për emetuesin

| | |
|------------------|--|
| Zëri 1 | Të dhënat e emetuesit |
| Zëri 1.1. | Vendbanimi dhe statusi juridik i emetuesit |
| Zëri 1.2. | Identifikuesi i subjektit juridik (NIPT) |
| Zëri 1.3. | Ligji sipas të cilit operon Emetuesi |
| Zëri 1.4. | Vendi i themelimit të Emetuesit |

SEKSIONI 5

Të dhënat e transaksioneve

Seksioni do të përsëritet për (i) çdo lloj instrumenti; (ii) çdo lloj transaksioni; (iii) çdo datë; dhe (iv) çdo vend ku janë kryer transaksionet

| | | |
|------------------|--|-------------|
| Zëri 1 | Përshkrimi i instrumentit financiar, lloji i instrumentit, kodi i identifikimit | |
| Zëri 1.1. | Indikacioni për natyrën e instrumentit: <ul style="list-style-type: none"> • një aksion, një instrument borxhi, një derivativ ose një instrument financiar i lidhur me një aksion ose një instrument borxhi • Kodi i identifikimit të instrumentit | |
| Zëri 2 | Natyra e transaksionit (Përshkrimi i llojit të transaksionit) | |
| Zëri 3 | Çmimi(et) | Vëllimi(et) |
| | <i>Kur më shumë se një transaksion i së njëjtës natyrë (blerje, shitje, huadhënie afatshkurtra, huamarrje afatshkurtrara, etj) në të njëjtin instrument financiar kryhen në të njëjtën ditë dhe në të njëjtin vend transaksioni, çmimet dhe vëllimet e këtyre transaksioneve do të raportohen në këtë fushë, në një formular me dy kolona, siç është paraqitur më sipër, duke përfshirë aq rreshta sa nevojiten.</i> | |
| Zëri 4 | Informacion i përmbledhur | |
| Zëri 4.1. | Vëllimi i agreguar | |
| | <i>Vëllimet e transaksioneve të shumta agregohen kur këto transaksione:</i> | |

| | |
|------------------|--|
| | <ul style="list-style-type: none"> • lidhen me të njëjtin instrument financiar; • janë të së njëjtës natyrë; • ekzekutohen në të njëjtën ditë; dhe ekzekutohen në të njëjtin vend transaksioni. |
| Zëri 4.2. | Informacion mbi çmimin |
| | <ul style="list-style-type: none"> • Në rast të një transaksioni të vetëm, çmimi i transaksionit të vetëm; • Në rast se vëllimet e transaksioneve të shumëfishta agregohen: çmimi mesatar i ponderuar i transaksioneve të agreguara. |
| Zëri 5 | Data e transaksionit |
| | <i>Data e ditës së caktuar të ekzekutimit të transaksionit të njoftuar.</i> |
| Zëri 6 | Vendi i transaksionit |
| | <i>Emri dhe kodi për të identifikuar platformën e organizuar të tregimit ku është ekzekutuar transaksioni</i> |